

UNITED NATIONS
United Nations
Interim
Administration
Mission in Kosovo




NATIONS UNIES
Mission
d'Administration
Intérimaire des Nations
Unies au Kosovo

KUVENDI I KOSOVËS СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

BULETINI

Shkurt, 2007 Nr. 15



Buxheti i vitit 2007 - 717 milionë euro

*Të hyrat buxhetore – katër për qind më të mëdha se sa në vitin paraprak
Investimet kapitale, si kategoria më e rëndësishme e shpenzimeve
publike- rreth 199.7 milionë euro*

KRYEPARLAMENTARI BERISHA PRITI
SHEFIN E UNMIK-ut, JOAKIM RYKER

Përshejtohet procedura e nënshkrimit të disa ligjeve që tashmë presin në sirtarët e UNMIK-ut

*Të thellohet edhe më bashkëpunimi
ndërmjet UNMIK-ut dhe Kuvendit
në fushën e legjislacionit*



Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kolë Berisha , kishte sot një takim me shefin e UNMIK-ut, Joakim Ryker . Temë qendrore e takimit ishte çështja e bashkëpunimit më të thelluar ndërmjet Kuvendit të Kosovës dhe Zyrës Ligjore të UNMIK-ut në lëmin e legjislacionit. Në këtë vështrim kryeparlamentari Berisha kërkoi që të përshejtohet procedura e nënshkrimit të disa ligjeve që tashmë presin në sirtarët e UNMIK-ut. Berisha u shpreh se do të jetë me interes që Zyra e UNMIK-ut të jetë më e pranishme në të gjitha fazat e hartimit të ligjeve , në mënyrë që pastaj mos të ketë dilema e vonesa në shpalljen e tyre, kështu njëkohësisht do të evitoheshin edhe punët e dyfishta në këto procedura.

Në këtë kontekst z. Ryker premtoi se do të angazhohet rreth mundësive për shpejtimin e punës së nënshkrimit të ligjeve , duke shfaqur bindjen se së shpejti do të nënshkruhen edhe disa ligje të tjera. Edhe në këtë takim u shprehën lëvdata për punën dhe përkushtimin e Kuvendit të Kosovës në hartimin dhe aprovimin e ligjeve të kërkuara nga ana e Grupit të Kontaktit. Në këtë frymë bashkëbiseduesit shprehën qëndrime unike për rëndësinë e Kuvendit të Kosovës në proceset e gjithmbarshme para dhe pas zgjidhjes së statusit të Kosovës.



PËRMBAJTTJA:

SHBA-të dhe BE-ja janë të interesuara për zgjidhjen sa më të shpejtë të statusit të Kosovës 9

Franca përkrah procesin dhe do të ndihmojë në konsensusin për statusin e Kosovës 10

Janë nënshkruar 22 marrëveshje me subjekte ndërkombëtare 13

Donatorët duan të ndihmojnë, por nuk pranojnë të paguajnë tatim për ndihmat që ofrojnë 15

Çështja e pronës duhet të rregullohet me Ligjin për pronën ... 15

Redaksia:

Sherif Konjufca, Shefqet Rexhepi, Celal Ilyas, Edona Fetahu

Telefonat Kontaktues:

038\ 211 186, 038\ 211 949, 038\ 211 189, 044\ 127 921

Tel/Fax: **038 211 188**

E-mail:

media@assembly-kosova.org

Web faqja:

www.assembly-kosova.org

Buxheti i vitit 2007 – 717 milionë euro

*Të hyrat buxhetore – katër për qind më të mëdha se sa në vitin paraprak
Investimet kapitale, si kategoria më e rëndësishme e shpenzimeve publike- rreth 199.7 milionë euro*



Deputetët e Kuvendit të Kosovës shqyrtuan dhe miratuan Projektligjin për Buxhetin e Kosovës për vitin 2007, në seanca të veçanta, para se të përfundojë viti 2006.



Me rastin e shqyrtimit të parë të projektligjit ekspozonë për këtë projektligj e ka paraqitur ministri për Buxhet dhe Financa, Haki Shatri, i cili

ka vënë në pah se të hyrat buxhetore për vitin e ardhshëm parashihen të jenë 682,2 milionë euro. Ai ka theksuar se deficitin prej rreth 34 milionë euro do të plotësohet nga keshi i rezervave, të cilat parashihet të rriten në rreth 75 milionë euro.

Në vazhdim ministri Shatri tha se Kosova si vend me ekonomi më të pazhvilluar në rajon, me probleme

strukurale zhvillimore, me papunësi të theksuar, me varfëri dhe me infrastrukturë ekonomike të dobët, nuk mund të sigurojë nga burimet e veta vëllim të të hyrave buxhetore në pajtim me nevojat që kemi. Shkalla e ngarkimit të ekonomisë me ngarkesa fiskale sillet rreth 29 për qind dhe është afër kufirit të lejuar për ngarkesa të mëtejshme fiskale të brutoproductit vendor. Të hyrat buxhetore për vitin 2007 janë 4 për qind më të mëdha se sa në vitin paraprak.

Rritja e të hyrave në brendi - 12.5 për qind më e lartë

Projeksioni i të hyrave është avancuar në 682.8 milion euro dhe ky version është plotësisht i realizueshëm.

Në këtë Projektbuxhet ndryshon pozitivisht edhe struktura e të hyrave buxhetore duke dinamizuar rritjen e të hyrave në brendi për 12.5 për qind

, kurse ato që vilen në kufi për 2.9 për qind. Të hyrat jotatimore dhe të hyrat vetanake të komunave janë projektuar më të ulëta se në vitin paraprak. Kufijtë e shpenzimeve buxhetore janë zgjeruar për 17.5 milionë euro ose për 2% në krahasimi me vitin buxhetor 2006.

Në këtë bilanc, që është vetëm nga të hyrat buxhetore, deficitin buxhetor i projektuar për vitin 2007 do të jetë 34 milion euro, ndërsa do të mbulohet nga keshi i rezervave të Qeverisë, që në fund të vitit 2007 do të jetë 75 milionë euro.

Struktura e shpenzimeve buxhetore në vitin 2007 do të ndryshojë dukshëm në favor të rritjes së investimeve kapitale, që janë rritur për 29 milionë euro në krahasim me vitin 2006.

Investimet kapitale, si kategoria më e rëndësishme e shpenzimeve publike në vitin 2007, kapin shumën

rreth 199.7 milion €.

Përmes rritjes së fondeve për investime, Qeveria ka siguruar bazën materiale për realizimin e prioritetëve të saj që lidhen me energjinë, ekonominë dhe edukimin. Për energjinë janë rekomanduar 21 milion euro.

Për arsimin në nivelin qendror janë paraparë 34.3 milionë euro, ndërsa granti për komuna 76.6 milion euro, pra gjithsej 110.9 milionë euro.

Për ndërtimin e rrugëve të reja dhe për rehabilitimin e rrugëve ekzistuese janë rekomanduar rreth 36 milionë euro.

Linja buxhetore për paga dhe mëditje ende zë vendin e parë me 202.9 milionë euro. Linja buxhetore për mallra dhe shërbime është zvogëluar për 8 milionë euro dhe kap shumën prej 132.2 milionë euro.

Linja buxhetore e subvencioneve dhe transfereve me rreth 154 milionë euro mbulon transferet sociale, pensionet bazike dhe pensionet e tjera, si dhe nevojat e tjera emergjente.

Me buxhetin e vitit 2007 do të mbulohen shpenzimet e regjistrimit të popullsisë, zgjedhjet lokale dhe qendrore dhe përveç ruajtjes së nivelit të rezervës së Qeverisë dhe të PSSP-së janë rezervuar edhe 4.5 milionë euro për vazhdimin e procesit të negociatave dhe të nevojës së menjëherëshme të passtatusit.

Me Projektbuxhetin e vitit 2007 nuk plotësohen nevojat dhe kërkesat e shumta të organizatave buxhetore, por ky projektbuxhet paraqet mundësinë tonë reale.

Subjektet që na mbështesin dhe na monitorojnë na rekomandojnë sjellje me kujdes, përgjegjësi dhe mbikëqyrje rigorozë të shpenzimeve buxhetore.

Në fund ministri Shatri i ftoi deputetët e Kuvendit ta miratojnë në parim Projektbuxhetin e vendit për vitin 2007.

Më pastaj deputet kanë zhvilluar një debat të gjerë për këtë projektligj, duke dhënë sugjerime, por edhe duke bërë kritika për zëra të veçantë të Buxhetit të Kosovës.

Naser Osmani, në emër të



buxhet, që janë të përcaktuara me Ligjin për menaxhimin e financave publike. Ai shprehu kënaqësi për disa trende pozitive që janë në këtë projektbuxhet.

Deficiti i përgjithshëm është zvogëluar nga 44 milionë, sa ishte në vitin 2006, në 30 milionë për vitin 2007; ka një rritje të ndjeshme në fushën e investimeve kapitale, që arrijnë në 199.7 milion euro, ose 19.3 milionë euro më tepër se në vitin paraprak

Projektbuxhetit i mungon pasqyra e projekteve të investimeve kapitale, ndaj kërkoj nga Qeveria ta sjellë atë dokument, si dhe kornizën makroekonomike mbi të cilën është përgatitur buxheti dhe dokumentet e tjera sqaruese, që mund të na ndihmojë në shqyrtimin e buxhetit.

Komisioni për Buxhet dhe Financa do ta shqyrtojë me kujdes këtë projektligj dhe do t'i paraqesë Kuvendit me kohë raportin me rekomandime.

Vlerësim joreal i burimeve të të hyrave



hyrave, që fillon nga të hyrat e mbledhura në kufi, të cilat janë paraqitur në mënyrë sintetike, por i mungojnë të dhënat analitike.

Ne konsiderojmë se vlerësimi i drejtë i burimeve të të hyrave, menaxhimi efikas, zvogëlimi i evazionit dhe e kontrabandës do të mundësonte që ne sot të diskutojmë

Komisionit për Buxhet e Financa dhe të Grupit Parlamentar të LDK-së tha se Qeveria vazhdon të mos i respektojë afatet për dorëzimin e Projektligjit për

të hyrat e tjera buxhetore.

Sa i përket shpenzimeve buxhetore nuk dihet vlera paralogaritur e projekteve.

Nëse FMN-ja nuk lejon ngritjen e pagave për shërbimin civil, atëherë pse po lejohet ngritja e pagave në fuqitë e rezervuara?

Te pozicioni mallrat dhe shërbimet nuk ka specifikim të shpenzimeve.

Ne, si grup parlamentar, jemi të interesuar ta dimë se mbi çfarë baze janë projektuar mjetet financiare për shpenzime kapitale të ministrive.

Projektbuxheti nuk ofron sqarime, se si iu ndahet buxheti komunave, çka merret parasysh? A ka të paraparë ndonjë stimulim buxhetor për komuna e varfra? Ky projektbuxhet nuk ofron perspektivë për zhvillimin ekonomik të vendit.

Duhet të sigurohen mjete më të mëdha për fushën e arsimit dhe shëndetësisë



Gjylnaze Sylaj, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, tha se fondet që janë pasqyruar në këtë projektbuxhet nuk i plotësojnë të gjitha nevojat, por një menaxhim

mirë i tij mundëson përmbushjen e nevojave më të rëndësishme.

Ministria e Ekonomisë dhe e Financave, në këtë projektbuxhet, ka demonstruar përkushtimin për disiplinë fiskale dhe stabilitet financiar.

Për Projektbuxhetin e vitit 2007 kemi edhe disa sugjerime:

E para, duhet siguruar mjete më të mëdha për fushën e arsimit dhe shëndetësisë.

E dyta, duhet siguruar fonde për zhvillimin e bujqësisë dhe të ekonomisë rurale.

E treta, mjetet e parapara për shpenzime dhe mallra, nëse nuk shfrytëzohen, duhet të alokohen për investime publike dhe zhvillim ekonomik.

E katërta, Kuvendit mos ta miratojë

buxhetin e paraparë për AKM-në pa pasur raport për shpenzimin e mjeteve të vitit të kaluar.



Nazim Jashari, në emër të Grupit Parlamentar të ORA-s, tha se në vazhdimësi po përsëritet që buxheti i Kosovës është buxhet i varfërisë, buxhet i fukarallëkut. Këtë sistem, që po e prodhon këtë buxhet të varfërisë, duhet ndryshuar. Kjo Qeveri dhe Ministri e Financave nuk e kanë kapacitetin e mjaftueshëm për ta ndryshuar këtë sistem. U mungojnë idetë, prej nga edhe fillon burimi i këtij buxheti të varfërisë.

Nëse e analizojmë buxhetin e vitit 2006 shohim se ka pasur keqmenaxhim, keqqeverisje, papërgjegjësi dhe gjitha këto sjellje me një automatizëm do të përcillen edhe për shpenzimin e buxhetit të vitit 2007.

Kosova e varfër, me vetëm 180 milionë euro për investime kapitale, e ka luksin që një milion euro të jenë të ngrirë, që e bart nga një vit në tjetrin, kur kemi deflacion, si pasojë e mungesës së parasë në qarkullim. Ai u angazhua për një transparencë më të madhe për shfrytëzimin e buxhetit gjatë vitit 2007, veçanërisht për buxhetet e komunave, që vërehet një laramani në parashikimin e shpenzimeve për zyrat e kryetarëve të komunave.

Nuk ka pozicion për subvencionimin e botimit të teksteve



Xhezair Murati, në emër të Grupit Parlamentar 6 plus, tha se si pjesëtar i bashkësive të vogla, pikërisht u nisa nga problemet që janë prezente në

Ministrinë për Komunitete dhe Kthim.

Në Ministrinë për Komunitete ne

nuk kemi pasur qasje, e as nuk kemi sqarime se si mund të ndihmohen komunitetet në mjediset ku jetojnë, në atë mënyrë që të favorizohen projektet të cilat nuk do të merren me kthim, por më tepër me ndaljen e shpërnguljes së tyre.

Konsideroj se përparësi duhet të ketë mosshpërngulja e bashkësive të vogla, sepse për kthimin e tyre do të nevojiteshin investime më të mëdha. Unë me këtë rast do t'i theksoja edhe disa probleme vitale për bashkësitë e vogla, p.sh. askund në buxhetin e Ministrisë së Arsimit nuk ka pozicion për subvencionimin e botimit të teksteve për pakicat, sepse tirazhi është i vogël dhe nuk ka leverdi për botimin e tyre.

Si shef i Grupit Parlamentar 6+, krahas të gjitha vërejtjeve të dhëna, konsideroj se ministria dhe Qeveria do t'i marrin parasysh të gjitha këto vërejtje serioze dhe në parim e përkrahim propozim- buxhetin për vitin 2007.



Numan Baliq, në emër të Grupit Parlamentar për Integrim, tha se duke e shikuar në tërësi buxhetin për vitin 2007, qëndrim yni është se ekziston

një tendencë e bartjes statike të buxhetit nga viti në vit, s'ka inventivitet të mjaftueshëm, nuk ka kthesa dhe ndryshime të rëndësishme që shpien kah ngritjet më të shpejta.

Lidhur me buxhetin për Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë, dhe Zhvillimit Rural (Kosova është një rajon fshatar me më tepër se 60% rajon bujqësor), për zhvillimin e fshatit janë ndarë 415.000 euro, prej shumës së përgjithshme të buxhetit të Kosovës që është 717 milion €, kjo është e patolerueshme. Lidhur me Ministrinë për Transport dhe Telekomunikacion, për ndërtimin e rrugëve të reja, janë ndarë 8.5 milionë euro, kurse për meremetimin, mirëmbajtjen dhe rehabilitimin e rrugëve janë ndarë 18 milionë euro.

Në lëmin e Ministrisë për Shëndetësi ka pozicione të mëdha, të cilat statikisht janë të papërshtatshme dhe jo premtuese. Qeveria nuk është në gjendje t'i rrisë pagat në të gjitha shërbimet civile. Paga e një mjeku te ne është 210 euro, kurse në vendet fqinje sillet prej 800 deri në 2000 euro.

Për shëndetësinë primare janë ndarë 455 mijë euro, d.m.th. më pak se një për qind nga buxheti i Kosovës, prandaj si është e mundur që me ndarje kaq të vogla ta përparojmë këtë degë, e cila u ofron shqërbime mbi 80 për qind të të gjithë pacientëve të Kosovës.

Deputetët e Kuvendit të Kosovës, në seancën plenare të 2- dhjetorit, nuk kanë arritur të votojnë për Projektligjin për buxhetin e Kosovës për vitin 2007.

Deputetë nga radhët e opozitës (Grupi Parlamentar i PDK-së, ai i ORA-s dhe ai për Integrim), fillimisht i kanë bërë kritika të shumta Projektligjit për buxhetin e Kosovës për vitin 2007, e pastaj e kanë braktisur seancën plenare. Pas pauzës prej dy orësh (për t'u konsultuar me shefat e grupeve parlamentare), është konstatuar se mungon kuorumi i nevojshëm për ta votuar buxhetin e Kosovës.

Nga deputetë të pozitës ka pasur edhe akuza se opozita po synon të krijojë krizë parlamentare.

Ndërkaq, në seancën 23 dhejtorit është miratuar Projektligji për buxhetin e Kosovës për vitin 2007.

Fillimisht janë miratuar, një nga një, amendamentet për këtë projektligj, kurse në fund me shumicë votash të deputetëve është miratuar Buxheti i Kosovës për vitin 2007, në vlerë prej 717 milion eurove.

Me këtë rast, janë miratuar edhe vija të veçanta buxhetore për katër agjencionet, të cilat i ka krijuar Kuvendi i Kosovës.

Në seancë nuk ka marrë pjesë Grupi Parlamentar i PDK-së, si dhe shumica e deputetëve të Grupit Parlamentar për Integrim.

Kufijtë e Kosovës janë të pandryshuar

*Parlamentarët gjermanë shprehen për perspektivën evropiane të Kosovës
Nuk bën të ketë prolongime të tjera të statusit*

Edhe pjesëtarët e minoritetit serb duhet të integrohen në shoqërinë e Kosovës

Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kolë Berisha, bashkë me anëtarët e Kryesisë, ka pritur sot një delegacion të Bundestagut gjerman të kryesuar nga Detlef Dzembritzki (nga grupi Parlamentar gjermano-jug evropian), me të cilin është biseduar për zhvillimet në Kosovë, për synimet e Kosovës e për integritet evropian dhe euroatlantike, si dhe për rolin që Gjermania mund të luaj si kryesuese e radhës së Unionit Evropian (nga 1 janari i vitit të ardhshëm) për zgjidhjen e çështjes së Kosovës, por edhe për mbështetjen e ekonomike të vendit tonë.

Kryeparlamentari Berisha, ka folur gjerësisht për përbërjen e Kuvendit (përfaqësimin politik dhe etnik), punën që ka bërë legjislativi i vendit për përmirësimin e standardeve, duke theksuar sidomos miratimin Ligjit për gjuhët, atij për Liritë fetare dhe të Ligjit për trashëgiminë kulturore. Ai, ndërkaq, ka theksuar synimin e qartë të institucioneve dhe të popullit të Kosovës për pavarësinë e vendit, por e ka shprehur edhe shqetësimin që ka ngjallur në Kosovë vendimi për shtyrjen e zgjidhjes së statusit deri pas zgjedhjeve parlamentare në Serbi. Me gjithë zhgënjimin që ka ngjallur kjo shtyrje, ka theksuar Berisha, institucionet dhe populli i Kosovës i besojnë bashkësisht ndërkombëtare prandaj duan ta vazhdojnë bashkëpunimin e mëtejshëm, por ai ka tërhequr vëmendjen se asesi nuk bën të ketë shtyrje të tjera për zgjidhjen e statusit.

Kryesuesi i delegacionit të Bundestagut gjerman, Detlef Dzembritzki, ka lavdëruar punën e përkushtuar të Kuvendit të Kosovës dhe të institucioneve të tjera të vendit për plotësimin e standardeve. Ai ka çmuar pjekurinë e klasës politike dhe ka shfaqur kënaqësi për qetësinë, me të cilën është pritur në Kosovë vendimi për shtyrjen e zgjidhjes së statusit. Ai është shprehur i bindur se nuk do të ketë shtyrje të tjera dhe ka premtuar angazhimin e vendit të tij, i cili



merr radhën e kryesimit të Unionit Evropian nga 1 janari i vitit 2007, jo vetëm për zgjidhjen e statusit, por edhe për përgatitjet që të gjitha vendet e rajonit të Evropës Juglindore, të integrohen në Unionin Evropian. "Kur kemi mundur të menaxhojmë me 450 milionë banorë të Unionit Evropian do të mundemi tas bëjmë këtë edhe me 23 milionë qytetarë shtesë të Evropës Juglindore", ka thënë Dzembritzki, i cili ka theksuar rëndësinë që kanë marrëdhëniet e mira fqinjësore për vendet e këtij rajoni.

Anëtar i tjetër i Bundestagut gjerman, Jyrgen Klimke (nga fraksioni CDU-CSU) është shprehur se nuk duhet të shtyhet zgjidhja e statusit të Kosovës dhe është angazhuar për një të ardhme evropiane të Kosovës. Duke pohuar se me gjithë faktin që Gjermania aktualisht ka vështirësi ekonomike, parlamentari gjerman ka theksuar se vendi i tij do ta ndihmojë Kosovën e passtatusit për integritet evropian, siç u ka ndihmuar një varg vendesh të tjera, sot anëtare të UE-së. Parlamentarët gjermanë kanë vlerësuar se pjesëtarët e minoritetit serb duhet të marrin pjesë në institucione dhe të integrohen në shoqërinë e Kosovës.

Anëtarët e Kryesisë, Ramë Buja, Naim Maloku, Xhavit Haliti dhe Mahir Yagcilar, duke e marrë fjalën në këtë takim, janë shprehur se nuk ka dallime ndërmjet pozitës dhe opozitës, për sa i përket statusit të vendit. Ata kanë theksuar se populli i Kosovës do ta kalojë

edhe rubikonin e 21 marsit (zgjedhjet në Serbi), që i është vënë, por kanë tërhequr vëmendjen se zgjidhja nuk duhet të vonohet për asnjë ditë. Që të gjithë kanë falënderuar për mbështetjen që Gjermania i ka dhënë Kosovës në të gjitha fazat e historisë së saj më të re dhe janë shprehur optimistë se Gjermania do ta luajë rolin e saj pozitiv, sidomos si kryesuese e radhës së UE-së.

Parlamentarët e Kosovës kanë theksuar resurset njerëzore dhe ato natyrore të vendit dhe kanë kërkuar mbështetjen gjermane për rimëkëmbjen e ekonomisë së Kosovës.

Anëtar i Kryesisë, Sabri Hamiti, u është përgjigjur pyetjeve të parlamentarit gjerman, Michael Brand (ka raportuar nga lufta në Kosovë) lidhur me të ardhmen e Mitrovicës dhe sistemin zgjedhor në Kosovë. Ai është shprehur prerë se nuk duhet të ndryshojnë kufijtë e Kosovës, që të mos ndodh, siç është shprehur ai, tërmet politik në gjithë Ballkanin. Hamiti ka theksuar se nuk mund të zbatohet asnjë zgjidhje si në Bosnje e Hercegovinë, kurse sistemin zgjedhor ka thënë se UNMIK-i ka imponuar një sistem proporcional, i cili jep rezultat joproporcional.

Takimet të tilla janë vlerësuar të dobishme, prandaj kryesuari i delegacionit parlamentar gjerman, Dzembritzki, e ka ftuar kryeparlamentarin Berisha dhe anëtarët e Kryesisë së Kuvendit për një vizitë pune në Bundestag.

Interes i theksuar për anëtarësim në Asamblenë Parlamentare të OSBE-së



Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kolë Berisha, ka pritur sot një delegacion katëranëtarësh të Asamblesë Parlamentare të OSBE-së, i udhëhequr nga presidenti Goran Lenmarker, të cilin e shoqëronte shefi i OSBE-së në Kosovë, ambasadori Werner Vnendt. I njëjti delegacion më pastaj është takuar edhe me anëtarët e Kryesisë së Kuvendit të Kosovës.

Kryeparlamentari Berisha, i ka njoftuar fillimisht parlamentarët e OSBE-së për punën e Kuvendit të Kosovës, sidomos sa i përket miratimit të ligjeve, kurse më pastaj është përqendruar në reformat parlamentare, të cilat konsistojnë në shtimin e kontrollit të punës së Qeverisë, pyetjet parlamentare, interpelancat, përgjigjet e kryeministrit dhe ministrave të resorëve etj. Berisha ka theksuar rëndësinë e bashkëpunimit me OSBE-në dhe ka shprehur interesin e theksuar të parlamentarëve të Kosovës për anëtarësim të vendit në Asamblesë Parlamentare të OSBE-së. Ai, ndërkaq, ka theksuar vullnetin

patundur të institucioneve dhe të qytetarëve të Kosovës për pavarësinë e vendit dhe është shprehur qartë nuk duhet të ndodh asnjë shtyrje tjetër e përcaktimit të statusit të vendit.

Është shumë i rëndësishëm kontrolli parlamentar i Qeverisë, është shprehur presidenti i Asamblesë Parlamentare të OSBE-së, Goran Lenmarker. Ai ka theksuar se qeveritarët shpeshherë harrojnë se çka kanë premtuar në programin e Qeverisë, prandaj Parlamenti duhet t'ua përkujtojë dhe t'i kontrollojë, siç duhet të kontrollohen të gjitha pushtetet e tjera. Ai i ka inkurajuar parlamentarët e Kosovës që në këtë fazë të formësimit të punës së Kuvendit, të mos e lihen anash rritja e kapacitetit dhe e formave të kontrollit parlamentar.

Anëtari i Kryesisë, Ramë Buja, ka lavdëruar punën e OSBE-ë për mbështetjen e katër palë zgjedhjeve në Kosovë dhe ka spikatur se pozita dhe opozita dallohen për shumë gjëra, por jo për sa i përket vullnetit

për pavarësinë e vendit.

Naim Maloku ka folur për ndihmën e OSBE-së për avancimin e punës parlamentare, duke u fokusuar në ndihmën që i është dhënë Komisionit parlamentar për Siguri, sa i përket kontrollit parlamentar të segmenteve të sigurisë.

Mahir Yagcilar është shprehur se janë krijuar hapësira të lakmueshme demokratike për avancimin e të drejtave të komuniteteve pakicë në Kosovë dhe për shprehje të lirë të mendimeve dhe të ideve për interesat e këtyre komuniteteve.

Gazmend Muhaxheri, ndërkaq, në fjalën e tij është përqendruar në nivelin jo të kënaqshëm të mbikëqyrjes parlamentare të Qeverisë, sidomos sa i përket shpenzimeve buxhetore të saj.

Në fund të takimit, Ambasadori Vnendt, ka shprehur kënaqësi për nivelin e bashkëpunimit me Kuvendin e Kosovës dhe është shprehur i gatshëm për thellimin e mëtutjeshëm të këtij bashkëpunimi të suksesshëm.

Më shumë para se ndërtim - vlerëson ekspertiza

- *Shqyrtohet raporti i ekspertizës për punët e kryera në Qendrën Administrative dhe Protokollare në Gërmi*
- *Rreth një milion euro është dallimi ndërmjet mjeteve të paguara punëkryesit dhe vlerës së ndërtimeve në QAP, sipas vlerësimit të ekspertizës*
- *Kryesia shqyrtoi edhe propozimin e Projektit për mbështetje të mëtejme Kuvendit të Kosovës për funksionalizimin dhe reformimin e administratës së Kuvendit*

Raporti i ekspertizës për punët e kryera në Qendrën Administrative dhe Protokollare në Gërmi, ka qenë tema kryesore e mbledhjes së sotme të Kryesisë së Kuvendit të Kosovës, të drejtuar nga Kolë Berisha, kryetar i Kuvendit.

Sipas ekspertizës, të cilën në emër të N.P.N. "NPE -ing" e ka prezantuar para anëtarëve të Kryesisë së Kuvendit, ing. Kenan Krasniqi, del se ka pasur jekompetencë profesionale të firmës ndërtimore

dhe të asaj për mbikëqyrjen e punimeve, kurse nga specifikimet e punëve të kryera dhe të materialeve të harxhuara, rezulton se Kuvendi i Kosovës i ka paguar ndërmarrjes ndërtimore MEGA nga Gjilani rreth një milion euro më shumë se sa vlera e ndërtimeve në Qendrën Administrative dhe Protokollare.

Po në këtë mbledhje të Kryesisë, mbikëqyrësi i punimeve në QAP, Bujar Demjaha, e ka quajtur të pa përfunduar dhe të pasaktë raportin e ekspertizës. Ai ka theksuar se ekspertiza nuk ka evidencuar shumë punë të kryera dhe materiale të shpenzuara. Nga llogaritë e tij rezulton të jenë shpenzuar të gjitha



paratë e paguara nga Kuvendi i Kosovës, megjithëse ekspertiza ka konstatuar se nuk është instaluar rryma dhe pajisjet tjera elektrike, për të cilën janë marrë 560 mijë euro, nuk është instaluar ngrohja qendrore dhe nuk është përfunduar pishina, për të cilat janë paguar mjetet, sikur të ishin të përfunduara. Kryesia e ka autorizuar sekretarin e Kuvendit, Ismet Krasniqi, që të kontaktojë me punëkryesin për të parë mundësitë e bashkëpunimit dhe të përfundimit të Vilës Gërmia, megjithëse ndonjëri nga anëtarët e Kryesisë ka deklaruar se tashmë është bjerrë besimi për afaristin, i cili madje kërkon edhe pagesa shtesë për punët e pakryera.

Kryesia po në këtë mbledhje ka shqyrtuar edhe propozimin e Projektit për mbështetje të mëtejme Kuvendit të Kosovës për funksionalizimin dhe reformimin e administratës së Kuvendit. Është konstatuar se propozimet për ndarjen e stafit politik nga shërbyesit civilë, si dhe ndarjet e sektorëve, sidomos forcimi i ekipit të zyrtarëve ligjor, do të reflektohet mirë në punën e Kuvendit. Krejt në funksion të përzgjedhjes së stafit dhe të autonomisë menaxhuese të Kuvendit të Kosovës, Projekti propozon amendamentimin e Ligjit për shërbyesit civilë, si dhe hartimin e Rregullores së funksionimit të administratës së Kuvendit.

Shpresohet se shumë shpejt Kosova do të jetë anëtare e Unionit Evropian

Proceset aktuale në Kosovë, çështja e statusit dhe thellimi i bashkëpunimit të mëtejshëm ndërparlamentar ishin tema kryesore të takimit të sotëm të kryetarit të Kuvendit të Kosovës, Kolë Berisha, me delegacionin e Senatit të Belgjikës, i kryesuar nga senatori François Roelants du Viver, udhëheqës i Komisionit për Marrëdhënie me Jashtë dhe Mbrojtje. Në përbërje të delegacionit ishin edhe senatori Lionel Vandenberghe, nënkryetar i Komisionit për Marrëdhënie me Jashtë dhe Mbrojtje, znj. Gerda Moors, bashkëpunëtoresh dhe Wim Peeters, shef i Zyrës Ndërlidhëse Belge në Prishtinë.

Biseda dhe tërë vizita e këtij delegacioni zhvillohet në dritën e faktit se Belgjika nga fillimi i këtij viti është anëtare e KS të OKB-së, ndërsa nga qershori ajo do të jetë edhe kryesuese e këtij Këshilli. Shih për këtë,

thi z. François Roelants du Viver, ndjekim me vëmendje punën e Parlamentit të Kosovës, me të cilin Parlamenti Belg ka bashkëpunim mjaft të mirë. Kemi përgjegjësi të njohim të sotmen, por të përgatitemi edhe për të ardhmen, pra si do të zhvillohet Kosova posaçërisht në aspektin ekonomik pas statusit.

Në vijim senatori Viver tha se Kosova gjeografikisht është në Evropë, ndaj edhe e ardhmja e saj është në Evropë. Ne do të mbështesim Kosovën në këtë drejtim. Senatori shprehu shpresën se shumë shpejt Kosova do të jetë anëtare e Unionit Evropian. Mirëpo për të arritur këtë, Kosovës i mbetet për të plotësuar shumë standarde evropiane, sidomos në fushën e legjislativitetit.

Kyryeparlamentari Berisha falënderoi Senatën dhe shtetin e Belgjikës për ndihmën që është

duke i ofruar Kosovës. Në këtë vështrim ky shtet po jep kontributin e tij të vlefshëm edhe në kuadër të Projektit për Mbështetje të Kuvendit të Kosovës. Lidhur me çështjen se çka pas zgjidhjes së statusit të Kosovës, kyryeparlamentari Berisha u shpreh për një prezencë të lehtë civile të Unionit Evropian, si dhe prezencë ushtarake ndërkombe-tare. Të dyja këto do të jenë faktorë stabiliteti, jo vetëm për Kosovën, por edhe për tërë rajonin, si në aspektin ekonomik ashtu edhe të lëvizjes së lirë të kapitalit dhe të qytetarëve. Kosova të ardhmen e shoh në UE, ndaj dhe angazhohemi denjësisht për plotësimin e standardeve evropiane sidomos, në legjislativitetin, tha Berisha.

Ky delegacion kishte një takim edhe me Komisionin për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim.

SHBA-të dhe BE-ja janë të interesuara për zgjidhjen sa më të shpejtë të statusit të Kosovës

Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kolë Berisha, ka pritur sot zëvendësen e ndihmësit të sekretares së shtetit të SHBA-ve, zonjën Rozmari Di Karlo, e cila shoqërohej nga Stefan Lehne, i dërguar i BE-së në bisedimet për statusin e Kosovës, si dhe udhëheqës të zyrave të shteteve perëndimore në Prishtinë dhe përfaqësues të mekanizmeve të tjerë evropiane, të interesuar për mbarëvajtjen e procesit për Kosovën.

Kyryeparlamentari Berisha e ka njoftuar delegacionin e lartë diplomatik për punën e Kuvendit të Kosovës, për reformat dhe ligjet e miratuara, sidomos ato që kanë rëndësi për standard-

et. Ai, ndërkaq ka folur edhe për detyrat e Kuvendit, sa i përket çështjes së statusit, ligjet që pritet të miratohen, hartimin e Kushtetutës, si dhe për rolin që do të ketë Kuvendi në gjithë procesin për përcaktimin e statusit. Kreu i legjislativitetit të vendit në këtë takim ka paraqitur edhe vizionet për modelin kushtetues të shtetit që do të ndërtohet. Zëvendësja e ndihmësit të sekretares së shtetit të SHBA-ve, Rozmari Di Karlo, ka shprehur konsideratat e saj për punën e Kuvendit të Kosovës dhe për drejtimin e duhur të legjislativitetit nga kryeparlamentari Berisha. Ajo ka theksuar edhe rolin e rëndësishëm që

do ta ketë Kuvendi deri në përcaktimin e statusit, si dhe në miratimin e ligjeve të nevojshme, në ndërkohë. Ajo e ka trimëruar zotën Berisha se reformat parlamentare janë çështje që duhet të vazhdojë. I dërguar i BE-së për bisedimet për statusin e Kosovës, Stefan Lehne, ka spikatur rëndësinë e bashkëpunimit të Bashkimit Evropian për përcaktimin e statusit të Kosovës. Diplomatat perëndimore, ndërkaq, kanë pohuar se SHBA-të dhe BE-ja janë të interesuara për zgjidhjen sa më të shpejtë të statusit të Kosovës, duke theksuar se qytetarët e Kosovës kanë nevojë ta qartësojnë statusin e vendit të tyre.

DELEGACIONI I KUVENDIT TË KOSOVËS NË VIZITË DYDITËSHE ZYRTARE NË FRANCË

Franca përkrah procesin dhe do të ndihmojë në konsensusin për statusin e Kosovës

Kryeparlamentari Berisha dhe delegacioni i Kuvendit të Kosovës u pritën nga kryetari i Kuvendit Nacional të Francës, Jean-Luis Debre, pastaj nga Eduard Baladur dhe nga zyrtarë të tjerë të lartë të Kuvendit Nacional të Francës

Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kolë Berisha, në kuadër të programit të vizitës në Francë, zhvilloi në Paris një takim të rëndësishëm në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Francës. Bashkë me kryeparlamentarin Berisha, në këtë takim morën pjesë edhe anëtarët e Kryesisë së Kuvendit të Kosovës: Naim Maloku e Ramë Buja, dhe deputeti Mahir Jakxhillar.

Nikoqirë të delegacionit të Kuvendit të Kosovës ishin tre zyrtarë të lartë të kësaj Ministrie, të ngarkuar me çështje të Ballkanit dhe të Kosovës: Jean-Francois Terral, drejtor i Departamentit për Evropën Kontinentale dhe njëkohësisht përfaqësues i Francës në Grupin e Kontaktit, z. Arnold Danjean, këshilltar i Ministrisë të Jashtëm, dhe z. Eduard Bellay, zëvendës drejtor i Departamentit për Ballkanin dhe çështjen e Kosovës. Janë këto tri personalitetet më të larta të diplomacisë së Francës që vazhdimisht kanë qenë të angazhuara rreth çështjes së Kosovës.

Kryeparlamentari Berisha paraqiti zhvillimet e fundit në Kosovë, me theks të veçantë në punën e bërë nga Kuvendi i Kosovës për realizimin e rolit demokratik dhe për punën që është bërë në të gjitha fushat edhe nga institucionet e tjera për përbushjen e standardeve të kërkuara nga bashkësia ndërkombëtare. Kryetari Berisha shprehu përkrahjen e institucioneve të Kosovës për punën e presidentit Ahtisari si dhe mirënjohjen për rolin aktiv e konstruktiv të Francës në Grupin e Kontaktit për zgjidhjen e statusit politik të Kosovës.



Kryetari i Kuvendit foli për vëmendjen e përqendruar me të cilën po pritet pakoja e presidentit Ahtisari dhe shfaqti shpresën se përmbytja e saj do të jetë në përputhje me vullnetin e shumicës së popullit për pavarësinë e Kosovës, si dhe paraqiti detaje për garancitë që ofrohen për pozitën e të gjitha minoriteteve në Kosovën e pavarur. “Kosova e pavarur do të jetë faktor stabiliteti në rajon”, tha kryeparlamentari Berisha.

Këshilltari i ministrit të Jashtëm të Francës, z. Arnaud Danajen, tha se Franca mbështet totalisht punën dhe pakon e presidentit Ahtisari. Propozimet e tij, tha ai, janë fryt i bisedimeve të zhvilluara në këtë proces. Kontributi i palës kosovare, tha ai, ka qenë pozitiv dhe shfaqti bindjen se përmbytja e pakos së Ahtisarit do të jetë pozitive dhe zgjidhja më e mirë dhe e vetmja e mundshme në këtë

moment, e cila do të ketë konsensusin e bashkësisë ndërkombëtare. Mesazhi tjetër që paraqiti zoti Danajen ishte se Kosova ka shumë nevojë pikërisht për konsensusin ndërkombëtar.

Për Pakon e Ahtisarit foli edhe Jean-Francois Terral, drejtor i Departamentit të kësaj Ministrie për Evropën Kontinentale dhe përfaqësues i Francës në Grupin e Kontaktit. Zoti Fransua Terral e theksoi shumë të rëndësishëm unitetin e Grupit të Kontaktit për çështje të Kosovës, sikundër që kërkoi që edhe pala kosovare duhet të jetë unike në këtë proces, i cili po e kalon një fazë shumë dinamike. Procesi nuk duhet të ndalet, tha ai, dhe është me rëndësi të vazhdojë kjo dinamikë drejt përfundimit të tij.

Në këtë bashkëbisedim morën pjesë edhe anëtarët e Kryesisë së Kuvendit të Kosovës, të cilët paraqitën argu-

mente dhe mendimet e tyre për aspekte të ndryshme të këtij procesi. Franca përkrah zgjidhjen e cila përfill vullnetin politik të shumicës në Kosovë, e cila duhet të arrihet me mbështetjen konsensuale të bashkësisë ndërkombëtare. Kjo mbështetje do të mbetet e rëndësishme së veçantë për Kosovën edhe pas definimit të statusit të saj.

Askush nuk ka arsye të frikësohet nga Kosova e pavarur

Në ditën e dytë të qëndrimit, delegacioni i parlamentarëve të Kosovës u prit në Paris nga kryetari i Kuvendit Nacional të Francës, Jean-Louis Debre.

Në një bashkëbisedim të ngrohtë e shumë miqësor u trajtuan tema të shumta, ndër të cilat dominuan çështjet e bashkëpunimit mes dy parlamenteve, por edhe aspektet politike lidhur me statusin e Kosovës në kontekstin e Pakos së Presidentit Ahtisari.

Kryeparlamentari Berisha theksoi se Kuvendi i Kosovës, por edhe institucionet tjera të vendit janë angazhuar me shumë seriozitet dhe kanë bërë pjesën e vet të punës, duke përmbytur standardet e kërkuara nga bashkësia ndërkombëtare. Në këtë kuadër, ai përmendi edhe rezultatet e punës së deritashme për pozitën e minoriteteve, si dhe garancitë juridike që do të kenë në Kosovën e pavarur. Tani, tha kryeparlamentari Berisha, presim fjalën e bashkësisë ndërkombëtare e në këtë kuadër edhe të Francës, e cila ka ndikim të fuqishëm, që statusi i Kosovës të marrë një zgjidhje të drejtë sipas vullnetit të shumicës së popullit të Kosovës. E, vullneti i shumicës tashmë dihet se është pavarësia e vendit. Askush, tha ai më tej, nuk ka arsye të frikësohet nga Kosova e pavarur, përkundrazi ajo do të jetë në interes të gjithë qytetarëve të saj, por edhe në interes të paqes e të stabilitetit në rajon.

Kryetari i Kuvendit Nacional të Francës, Jean-Louis Debre, lidhur me statusin e Kosovës u shpreh me optimizëm se procesi po shkon dhe do të shkojë në drejtim të duhur, në atë drejtim që do të sjellë zgjidhje pozitive

në interesin e të gjithëve. Prandaj, tha ai, këtij procesi duhet t'i kontribuojmë të gjithë.

Kryetari i Kuvendit Nacional të Francës konstatoi rëndësinë e veçantë që i jep Franca konsensusit ndërkombëtar për zgjidhjen e statusit të Kosovës. Franca, tha ai, përkrah këtë proces dhe ka një ndikim real në Këshillin e Sigurimit të OKB-së, si dhe në BE, duke shtuar se shumëçka varet edhe nga vetë kosovarët, nga angazhimi dhe imazhi që kosovarët japin para botës. Një rëndësi të veçantë në këtë proces që kërkon kohë e durim, ka edhe bashkëpunimi aktiv i dy kuvendeve tona, tha Debre. Një pjesë e madhe e takimit iu kushtua pikërisht bashkëpunimit ndërparlamentar, përvojave të deritashme dhe mundësive për të vazhduar më tej me projekte të reja. Ishte konstatim i përbashkët se duhet të vazhdojë puna e konsorciumit të katër parlamenteve evropiane, sepse bashkëpunimi i deritashëm është vlerësuar shumë i dobishëm për avancimin e përvojave në Kuvendin e ri të Kosovës. Gjatë bashkëbisedimit u theksua edhe rëndësia e faktorit ekonomik, sepse, pa zhvillim ekonomik, të gjitha proceset vihen në pikëpyetje.

Në këtë takim folën edhe anëtarët e Kryesisë, Naim Maloku e Ramë Buja, dhe deputeti Mahir Jakxhillar, të cilët dhanë kontributin e tyre për temat e bisedës. Në këtë delegacion ishin edhe dy këshilltarët e Kryetarit të Kuvendit, Ramë Manaj e Skënder Durmishi, si dhe sekretari Kuvendit, Ismet Krasniqi.

Delegacioni i Kuvendit të Kosovës vlerëson se kjo vizitë në Paris ishte e rëndësishme, e dobishme dhe shumë e suksesshme, para së gjithash për konfirmimin e vendosmërisë së vazhdimit të bashkëpunimit ndërparlamentar dhe përkrahjes së Francës për procesin e definimit të statusit të Kosovës.

Në Kuvendin Nacional të Francës, kryeparlamentari Berisha u prit me ngrohtësi të veçantë dhe me ceremoni me të cilat priten personalitetet e larta.

Gjatë ditës së dytë të vizitës, delegacioni i Kuvendit të Kosovës asistoi në

një seancë të pyetjeve të deputetëve francezë për Qeverinë, si dhe ndoqi nga afër disa aspekte që bëjnë specifikat e punës në Kuvendin Nacional të Francës.

Delegacioni kosovar u prit përzemërsisht dhe zhvilloi bisedime të efektshme edhe me Cristian Menard, deputet dhe kryetar i Grupit punues të Parlamentit të Francës për miqësi me Kosovën. Kryeparlamentari Berisha falënderoi zotin Menard për angazhimet e deritashme dhe bashkërisht u dakorduan për një agjendë të takimeve më intensive në të ardhmen.

Kryeparlamentari Berisha u prit nga Eduard Baladur

Në kuadër të programit të vizitës zyrtare të delegacionit të Kuvendit të Kosovës në Paris, një takim mjaft i rëndësishëm u zhvillua edhe me Eduard Baladur, ish-kryeministër i Francës dhe kryetar aktual i Komisionit për Marrëdhënie me Jashtë në Kuvendin Nacional të Francës.

Pas një bashkëbisedimi lidhur me zhvillimet më kryesore në Kuvendin e Kosovës dhe specifikat politike e juridike por edhe përbërjen etnike të Kuvendit, biseda u përqendrua kryesisht në agjendat e mundshme në vazhdim për procesin e zgjidhjes së statusit të Kosovës si dhe për rolin e veçantë që ka e që do të ketë Kuvendi i Kosovës.

Zoti Baladur, duke konstatuar kompleksitetin e problemit të Kosovës, theksoi se është e pakontestueshme e drejta e popullit të Kosovës që të vendosë për fatin dhe për të ardhmen e vet. Kjo e drejtë, tha ai, duhet të shtrohet dhe të realizohet në kontekstin e situatave reale të momentit, që do të thotë se është shumë me rëndësi të arrihet me konsensus.

Zgjidhja konfliktuale nuk i duhet Kosovës, por i duhet një zgjidhje që e pranojnë të gjithë. Franca do të bëjë maksimumin për të arritur këtë konsensus dhe do të angazhohet maksimalisht që në Këshill të Sigurimit të OKB-së askush të mos përdorë veton lidhur me statusin e Kosovës. Kemi vullnetin e mirë dhe dëshirën që të ndihmojmë, përfundoi Baladur.

Qëndrim unik i klasës politike shqiptare për statusin e Kosovës

- *Të thellohet bashkëpunimi gjithëpërfshirës ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë*
- *Shqipëria dhe Kosova pas statusit do të angazhohen për integritet kombëtar, rajonale dhe euroatlantike*
- *Rruga Durrës-Kukës-Morinë do ta lehtësojë integrimin dhe do t'i shërbejë zhvillimit të dy vendeve*

Komisioni për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Integritet Euroatlantike i Kuvendit të Kosovës, kryesuar nga Sabri Hamiti, kryetar i Komisionit, ka pritur sot në një takim të përbashkët delegacionin e Komisionit për Politike të Jashtme të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, të prirë nga Preç Zogaj, kryetar i këtij Komisioni, për të këmbyer mendime për thellimin e bashkëpunimit institucional ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë, për mbështetjen reciproke në këtë fazë të përcaktimit të statusit për Kosovën dhe për synimet e përbashkëta lidhur me integritet kombëtar, rajonale dhe euroatlantike, të cilat vlerësohen kusht i domosdoshëm për zhvillim, paqe e stabilitet të rajonit.

Duke e përshëndetur këtë vizitë të parlamentarëve shqiptarë dhe duke e vlerësuar shumë pozitivisht bashkëpunimin institucional të dy kuvendeve, Sabri Hamiti i ka ftuar pjesëmarrësit e këtij takimi të shprehën në mënyrë të lirshme për çështjet që i preokupojnë deputetët e të dy vendeve.

Kryetari i Komisionit për Politike të Jashtme të Kuvendit të Shqipërisë, Preç Zogaj, duke falënderuar për ftesën për vizitë, e ka vlerësuar tepër të rëndësishme takimin e përfaqësuesve të zgjedhur të popullit dhe ka theksuar nevojën e forcimit të dimensionit parlamentar ndërmjet Tiranës dhe Prishtinës. Ai me këtë rast ka përvijuar qëndrimin e shtetit shqiptar për raporte partneriteti me Bashkimin Evropian dhe SHBA-të për zgjidhjen e statusit të Kosovës, konform qëndrimeve të Grupit të Kontaktit, agjendës së kryenegociatorit Ahtisari, si dhe vullnetit të popullit të Kosovës, zgjidhje kjo që krijon paqe e stabilitet në rajon. Duke përkujtuar rëndësinë që shteti shqip-



tar i jep zhvillimit të papenguar të të gjitha bashkësive etnike në Kosovë, Zogaj ka përmendur si shembull pakicën greke në Shqipëri, e cila i ka gëzuar të drejtat maksimale, madje edhe në kohën e komunizmit.

Në vazhdim Zogaj ka përmendur luftën që po bën Shqipëria kundër krimit të organizuar dhe për vendosjen e shtetit ligjor. Ai, ndërkaq, ka theksuar në mënyrë të veçantë vendosmërinë e shtetit shqiptar për të ndërtuar rrugën Durrës-Kukës-Morinë, e cila do ta lehtësojë integrimin ndërshtetëtar e rajonal dhe do t'i shërbejë zhvillimit të të dy vendeve, madje edhe pjesës jugore të Serbisë.

Anëtarët e Komisionit për Bashkëpunim Ndërkombëtar: Nexhat Daci, Xhezair Murat, Xhavit Haliti e Teuta Sahatxhiu, kanë folur për aspekte të veçanta të bashkëpunimit Kosovë-Shqipëri, me theks të veçantë mbështetjen e zgjidhjes së çështjes së Kosovës, sipas vullnetit politik të popullit të saj, si dhe kanë shprehur qëndrimin unik për pavarësinë e vendit dhe të drejtat e garantuara për të gjitha minoritetet në Kosovë. Deputeti Gjergj Dedaj, ndërkaq, ka qenë kritik ndaj institu-

cioneve të Kosovës, sidomos për vonesën e përcaktimit të statusit.

Edhe parlamentarët tjerë nga Shqipëria: Kastriot Islami, Luan Skuqi dhe Neritan Ceka, u kanë garantuar deputetëve të Kosovës se në Shqipëri nuk ka dallim ndërmjet forcave politike për sa i përket të ardhmes së Kosovës. Ata e kanë vlerësuar të pjekur klasën politike të Kosovës që ka marrë obligimin ta realizojë statusin e Kosovës, sipas vullnetit popullit, duke shtuar se një Kosovë e pavarur do të reflektojë paqe e stabilitet në gjithë rajonin dhe se zgjidhja e tillë do ta lironte edhe vetë Serbinë.

Në përfundim të takimit, kryetari i Komisionit për Bashkëpunim Ndërkombëtar, Sabri Hamiti, ka përkujtuar thëniet e presidentit të ndjerë Rugova për njohjen ndërkombëtare të pavarësisë së Kosovës, si dhe për marrëdhëniet e mira me BE-në dhe miqësi të përhershme me SHBA-të. Ndërkaq, duke u shprehur në mënyrë të figurshme për magistratën që lidh Kosovën me Shqipërinë është shprehur: "Kur lidhet mali me detin, bëhet qarkullimi i njerëzve dhe i mallrave, por edhe i interesave dhe i emocioneve".

Janë nënshkruar 22 marrëveshje me subjekte ndërkombëtare

- *Aktivitet i ngjeshur ndërkombëtar i kryeministrit në funksion të afirmimit të Kosovës dhe zgjidhjes së çështjes së saj*
- *Agjenda Evropiane është prioritet i Qeverisë së Kosovës*
- *Janë shtuar përkrahësit e jashtëm të pavarësisë së Kosovës dhe janë pakësuar kundërshtarët e saj*
- *Komisioni ka miratuar planin vjetor të punës dhe ka përshëndetur dy rezolutat në procedurë për pavarësinë e Kosovës*

Kryeministri i Kosovës, Agim Çeku, ka marrë pjesë sot në një seancë dëgjimore në mbledhjen e Komisionit parlamentar për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Integritet Euro-Atlantike, në të cilën ka shkoqitur aktivitetin e ngjeshur ndërkombëtar të Qeverisë së Kosovës dhe të atij personalisht, në funksion të afirmimit të Kosovës dhe zgjidhjes së çështjes së saj.

Çeku me këtë rast ka përmendur vizitat e shpeshta të burrështetasve dhe qeveritarëve të vendeve të ndryshme në Kosovë, si dhe vizitat e tij në 17 vende të ndryshme, gjithnjë sipas protokollit shtetëror. Kryeministri ka theksuar se janë nënshkruar 22 marrëveshje me subjekte ndërkombëtare, shumë të rëndësishme për Kosovën dhe qytetarët e saj. Agjenda Evropiane është prioritet i Qeverisë së Kosovës, ka theksuar Çeku, i cili në këtë kuadër ka spikatur Planin e Veprimit për Partneritet Evropian, si dhe krijimin e grupeve punuese për realizimin e këtij plani, Mekanizmin Përcjellës të Stabilizimit Asocimit, krijimin e Agjencionit për Integritet Evropian, si dhe funksionimin e zyrave për integritet evropian në të gjitha ministratë e Qeverisë, të cilën e udhëheq. Si rezultat të këtyre veprimeve, që janë ndërmarrë, janë shtuar përkrahësit e jashtëm të pavarësisë së Kosovës dhe janë pakësuar kundërshtarët e saj, ka theksuar Çeku. Ai me këtë rast ka folur edhe për dokumentin e Ahtisarit, si dhe



për qëndrimet e shteteve të veçanta për të ardhmen e Kosovës. Në këtë vështrim ai ka përmendur edhe vizitën që do të bëjë në Kinë më 12 dhe 13 shkurt dhe ka shprehur vullnetin që në këtë vizitë të rëndësishme ta shoqërojnë edhe dy anëtarë të Komisionit për Bashkëpunim Ndërkombëtar.

Kryetari i Komisionit për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Integritet Euro-Atlantike, Sabri Hamiti dhe anëtarët e tjerë të komisionit, e kanë vlerësuar aktivitetin diplomatik të kryeministrit Çeku dhe përgjigjen e tij pozitive për këtë seancë dëgjimore. Ata e kanë vlerësuar shumë të rëndësishëm koordinimin e aktivitetit ndërkombëtar të Qeverisë me diplomacinë parlamentare të Kuvendit të Kosovës dhe promovimin e Kosovës si vend i hapur që prodhon paqe e siguri në rajon.

Komisioni, po sot, ka miratuar planin vjetor të punës, në të cilin përvijohen kompetencat dhe përgjegjësitë e komisionit pas statusit politik të vendit; puna sipas Rezolutës për rikonfirmimin e vullnetit politik të qytetarëve të Kosovës për shtet të pavarur dhe sovran, si dhe shqyrtimin e Pakos së Ahtisarit dhe rolin aktiv rreth përcaktimit të statusit në etapat e vendimit dhe të zbatimit të tij. Në programin e punës theksohen marrëdhëniet e vazhdueshme të komisionit me parlamentet në rajon, në Evropë dhe në SHBA, kurse sa i përket aktiviteteve legislative theksohet miratimi i ligjeve themelore sistemore, Kushtetutës, Ligjit për Zgjedhjet, atij për Pushtetin Lokal etj. Anëtarët e komisionit kanë përshëndetur dy rezolutat në procedurë për pavarësinë e Kosovës: atë në Kongresin Amerikan dhe atë në Parlamentin Evropian.

Politika e Beogradit po i pengon serbët vendës të angazhohen në TMK

Piramida strukturale aktuale e TMK-së, përkatësisht numri i madh i oficerëve kundruall ushtarëve në TMK, shtron si domosdoshmëri aprovimin e një ligji për pensionim të parakohshëm të disa eprorëve të TMK-së, tha gjeneralletënant Sylejman Selimi



Komisioni për Siguri i Kuvendit të Kosovës, i kryesuar nga Naim Maloku, kryetar i Komisionit, organizoi sot një dëgjim publik me Trupat e Mbrojtjes së Kosovës, të udhëhequra nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm të TMK-së, gjeneralletënant Sylejman Selimi, përkitazi me ngritjen e kapaciteteve të mbikëqyrjes parlamentare mbi institucionet e gatishmërisë emergjente, në bashkëpunim me KIPRED-in dhe me OSBE-në.

Në fillim të këtij dëgjimi, Naim Maloku, theksoi se në kuadër të ngritjes së kapaciteteve të mbikëqyrjes parlamentare mbi institucionet e gatishmërisë emergjente është formuar Komisioni për Siguri i Kuvendit të Kosovës, i cili po merr kompetencat përkatëse në fushën e sigurisë.

Në vijim anëtarët e Komisionit shtruan disa pyetje rreth punës së TMK-së dhe vizioneve të së ardhmes së saj. Mbi

këto çështje anëtarët kishin edhe një raport me shkrim, por kësaj radhe ata dhe pjesëmarrësit tjerë merrnin informata edhe më të gjera. Në këtë frymë gjeneralletënant Sylejman Selimi theksoi se edhe TMK-ja, si pjesë e shoqërisë kosovare është në një proces shumë të rëndësishëm, në pritje të pakos së Ahtisarit dhe përgjithësisht zgjidhjes së statusit të Kosovës. Ne, theksoi në vijim Selimi, kemi idetë dhe vizionet për të ardhmen e TMK-së, të strukturës mbrojtëse të vendit. Këto ua kemi dorëzuar të gjitha institucioneve më të larta të vendit, sepse ato në bashkëpunim me strukturat ndërkombëtare do të vendosin rreth të ardhmes së strukturës mbrojtëse të Kosovës.

Piramida strukturale aktuale e TMK-së, përkatësisht numri i madh i oficerëve kundruall ushtarëve në TMK, shtron si domosdoshmëri aprovimin e një ligji për pensionim të parakohshëm

të disa eprorëve të TMK-së, tha pastaj gjeneralletënant Sylejman Selimi. Nga disa shkaqe një numër eprorësh nuk do të mund të angazhohen në strukturat mbrojtëse, qoftë për shkak të moshës, invaliditetit etj., ndaj për këtë çështje duhet të kemi një ligj, me të cilin do të rregullohet statusi i tyre, tha Selimi. Me këtë rast gjeneralletënant Sylejman Selimi foli edhe për segmente të tjera të veprimtarisë së TMK-së. Duke folur rreth rekrutimit të pjesëtarëve të komuniteteve në TMK, ai theksoi se politika e dirigjuar nga Beogradi po pengon serbët vendës të angazhohen në TMK, me gjithë dëshirën e tyre. TMK-ja, ndërkaq, bën gjithçka që është e mundur për krijimin e kushteve për rekrutim të pjesëtarëve të të gjitha komuniteteve, e sidomos për pjesëtarët serbë, për të dëshmuar se kjo trupë është e të gjithë qytetarëve të vendit.

Donatorët duan të ndihmojnë, por nuk pranojnë të paguajnë tatim për ndihmat që ofrojnë

Parregullsitë e Rregullores së tashme mbi TVSH-në të mos përsëriten në Projektligjin për tatimin në vlerën e shtuar, përkatësisht në Ligjin e ri



Aplikimi i TVSH-së edhe për mallra që ofrohen si ndihmë humanitare ka sjellë OJQ-të përkatëse në një situatë të pa rrugëdalje. Kjo paraqitet si pengesë edhe për vazhdimin e veprimtarisë së tyre. Donatorët duan të ndihmojnë, por nuk pranojnë të paguajnë tatim për ndihmat që ofrojnë. Në këtë situatë ata po detyrohen, pa dëshirën e tyre, që të orientohen për t' i ofruar ndihmat e tyre në shtete e tjera, e jo në Kosovë. Zbatohet TVSH-ja madje edhe për veshmbathje të bajtur, si dhe për material shkollor për fëmijë të shtresave më të varfra të shoqërisë kosovare. Aplikimi i TVSH-së paraqitet si pengesë edhe në veprimtarinë e mediave të shkruara dhe të atyre elektronike. Këto ishin disa nga konstatimet themelore që u thanë në dëgjimin publik të organizuar nga Komisioni për Buxhet dhe Financa i Kuvendit të Kosovës, i kryesuar nga Naser Osmani, kryetar i Komisionit, lidhur me Projektligjin për tatimin në vlerën e shtuar në Kosovë, në të cilin mermin pjesë përfaqësues të organizatave joqeveritare dhe të mediave të

shkruara dhe elektronike.

Përfaqësuesit e këtyre organizatave paraqitën shembuj të shumtë nga rajoni dhe Evropa, ku TVSH-ja ose nuk aplikohet fare për veprimtarinë e këtyre organizatave, ose edhe nëse parashihet një gjë e tillë, ajo është tejet e ulët. Ata këmbëngulnin se sipas logjikës së thjeshtë nuk mund të tatimohet humaniteti. Kur është fjala për media ata kërkonin heqjen e TVSH-së duke e ditur se me çfarë vështirësish ballafaqohen mediat. Duke hequr TVSH-në ato do të kishin kushte më të volitshme për zhvillim, por edhe për të ruajtur pavarësinë e tyre. Të gjithë diskutuesit kërkonin që anomalitë dhe parregullsitë e Rregullores së tashme mbi TVSH-në të mos përsëriten në Projektligjin për tatimin në vlerën e shtuar, përkatësisht në Ligjin e ri.

Nga kryetari i Komisionit, Naser Osmani, por edhe nga anëtarët tjerë, u tha se këto vërejtje të këtij dëgjimi publik do të merren parasysh. Po kështu, do të kenë parasysh edhe praktikën më të mira në këtë fushë nga shtetet e rajonit dhe Evropa.

Çështja e pronës duhet të rregullohet me Ligjin për pronën

Projektligji për paluajtshmëritë ... vërehet se është i nxituar, ai nuk është koherent, as me kohën, as me qëllimin

Komisioni për Shërbime Publike, Administratë Lokale dhe Media i Kuvendit të Kosovës, kryesuar nga Nekibe Kelmendi, kryetare e Komisionit, mbajti sot një dëgjim publik lidhur me shqyrtimin e Projektligjit për shndërrimin e poseduesve të paluajtshmërive private në pronarë nr.2006/20.

Gjatë debatit të gjerë ekspertët e fushës civile ishin unanimë në konstatimin se qëllimi i sponsoruesit – Qeverisë së Kosovës ishte i mirë, por nuk është gjetur forma dhe mënyra adekuate e hartimit të këtij Projektligji. U tha se disa nene janë të njëjta me Ligjin për kadastër, ndaj edhe mund të inkorporohen në atë Ligj, madje disa nene mund të inkorporohen edhe në ligjet e tjera ekzistuese. Projektligji vërehet se është i nxituar, ai nuk është koherent, as me kohën, as me qëllimin. Çështja e pronës duhet të rregullohet me Ligjin për pronën, kështu që edhe nga ky vështrim Projektligjit për shndërrimin e poseduesve të paluajtshmërive private në pronarë nr.2006/20, nuk mori notë kaluese nga ekspertët, por sipas disponimit edhe të komisionit shihej më e udhës që ai të tërhiqet nga procedura.

Kërkesat për energji gjithnjë në rritje

Situata aktuale energjetike në Kosovë është mjaft e vështirë, para së gjithash për faktin se nevojat për energji elektrike janë më të mëdha se prodhimi. Mungesa e energjisë elektrike në Kosovë është, para se gjithash, rezultat i eksploatimit të pamjaftueshëm të thëngjillit nga mihjet sipërfaqësore, i amortizimit të termocentraleve, i vjetërimit të rrjetit të furnizimit, i vjedhjes së energjisë elektrike nga shfrytëzuesit e ndryshëm, i mospagesës së mjaftueshme të energjisë elektrike nga ana e konsumatorëve etj. Këtë situatë e vështirëson edhe më tepër gjendja e rëndë energjetike në rajon, gjë që pamundëson importin e saj. Këto janë vetëm disa prej konstatimeve nga mbledhja e rregullt e Komisionit të Ekonomisë, Tregtisë, Industrisë, Energjetikës, Transportit dhe Telekomunikacionit të Kuvendit të Kosovës, që e kryesoi z. Ibush Jonuzi,

kryetar i Komisionit, pikë e vetme e rendit të ditës e së cilës ishte situata aktuale energjetike në Kosovë.

Në këtë mbledhje, krahas anëtarëve të Komisionit morën pjesë edhe zëvendësministri në Ministrinë e Energjetikës dhe të Minerave, z. Agron Dida, drejtoresha e KEK-ut, zonja Pranvera Dobruna dhe përfaqësuesit e Zyrës së Rregullatorit të Energjisë dhe të Komisionit të Minerave dhe Mineraleve. Në mbledhjen e përmendur, pos tjerash u tha se në vitin 2007 nevojat e Kosovës për energji elektrike do të jenë gjithsej 5.118.460 megavat orë, ndërkaq do t'i ketë në dispozicion 4.833.173 megavat orë (nga prodhimi në termocentrale 4.159.893 dhe nga importi 673.280 megavat orë), kështu që do të kemi një mungesë të energjisë elektrike prej 285.287 megavat orë. Tani për tani nuk ekzistojnë plane konkrete se në çfarë mënyre do të kompensohet

kjo mungesë e energjisë elektrike, por po punohet që Kosova në vitin e ardhshëm të ketë një furnizim më të mirë me energji elektrike në krahasim me këtë vit.

Në mbledhje u bë fjalë edhe për mundësitë e daljes nga kjo situatë e pavolitshme, me ç'rast u potencua nevoja e modernizimit dhe e shfrytëzimit më të mirë të mihjeve sipërfaqësore, e zëvendësimit të pajimeve të vjetruara, si në termocentrale, ashtu edhe në rrjetin e distribuimit, e gjetjes së mënyrave adekuate për sigurimin e një arkëtimit më të madh të energjisë së harxhuar elektrike, në rend të parë nga institucionet shtetërore dhe nga fabrikat e ndërmarrjet private. Po ashtu, u konstatua se duhet të rritet edhe përgjegjësia e menaxhmentit, por edhe e punëtorëve të KEK-ut për realizimin e planeve dhe programeve që kanë të bëjë me stabilizimin e situatës energjetike në Kosovë.

Projekti për Mbështetje të Kuvendit të Kosovës synon reformimin e administratës së Kuvendit

Projekti "Mbështetje e Mëtejme për Kuvendin e Kosovës", i financuar nga katër parlamente evropiane, që nga fillimi i këtij viti, ka thelluar bashkëpunimin me Kuvendin e Kosovës për reformimin e administratës së Kuvendit, Rregullores së Punës të Kuvendit të Kosovës, njohjen me praktikat e mira të punës së komisioneve dhe komunikim më të mirë me qytetarë.

Projekti, tanimë ka hyrë në një fazë të re, me planin e reformimit të administratës së Kuvendit (hap pas hapi), me qëllim të ngritjes së efikasitetit dhe përgatitjes së Kuvendit për rolin e tij të rëndësishëm që ka për të ardhmen, si institucion qendror demokratik i vendit.

Në këtë fazë të re, udhëheqësi i ri i Projekti është emëruar z. Hugues de Courtivron, i cili ka karrierë të pasur



ushtarake, diplomatike dhe civile në rajonin e Ballkanit dhe për çështje që kanë të bëjnë me të.

De Courtivron ka qenë i angazhuar në Bosnje e Hercegovinë dhe në Kosovë, si gjeneral brigade (që nga viti 1994), kurse nga viti 2003 ka punuar si ekspert civil. Ai ka qenë udhëheqësi i stafit në misionin e

UNPROFOR-it në Sarajevë (1994) dhe gjeneral brigade në KFOR (2001/2002).

Pas pensionimit ka punuar si drejtor rajonal në misionin e OSBE-së në Tuzëll, dhe pastaj edhe si ekspert (në rol të konsulentit) në Qendrën për Kontroll Demokratik të Forcave të Armatosura (DCAF), në Gjenevë.

Ai ka kualifikim në shkencë politike, në punën me parlamente dhe komisione parlamentare, në histori, komunikim dhe analiza strategjike. Është i martuar dhe është baba i dy fëmijëve. Sprova e tij e parë në projektin për Mbështetje Kuvendit të Kosovës ishte seminari për deputetë dhe staf civil të Kuvendit në temën: "Mbikëqyrja parlamentare e procedurave qeveritare, tash dhe pas statusit", mbajtur ditë më parë në Prishtinë.

Ligjëruan përfaqësues të katër parlamenteve evropiane

Seminarin e ka hapur Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kolë Berisha, i cili ka spikatur rolin ligjvënës dhe përfaqësues të Parlamentit, përfshirë edhe kontrollin permanent të Qeverisë, ka theksuar përvojën e mangët të jetës së vërtetë parlamentare në Kosovë dhe nga kjo edhe nevojën për të mësuar nga vendet me tradita të fuqishme demokratike parlamentare. Pasi që të pranishmit i ka përshëndetur Hugues de Courtivron (Projekti: Mbështetje e mëtejme për Kuvendin e Kosovës), deputetëve dhe punonjësve të Kuvendit të Kosovës, të ndarë në katër panele, përfaqësues me përvojë parlamentare nga vendet të cilat kanë krijuar Konzorciumin (Asambleja Nacionale Franceze, Bundestagu Gjerman, Dhoma e Përfaqësuesve Belg dhe Asambleja Nacionale e Sllovenisë), që e financon Projektin, u kanë përcjellë përvojat parlamentare të vendeve të tyre, lidhur me mbikëqyrjen parlamentare të Qeverisë.

Në panelin e parë, në temën **“Mbikëqyrja në seancë plenare, koha për pyetje, interpelanca dhe forma tjera të debatit”**, kanë ligjëruar Marcel Dehoux, (Asambleja Franceze) dhe Christian Majewski, (Bundestagu Gjerman), të cilët kryesisht janë përqendruar në përvojat e parlamenteve të vendeve të tyre lidhur me pyetjet e deputetëve, interpelancën, mocionet për mosbesimin e Qeverisë dhe komisionet hetimore, kurse deputeti Naim Jerliu (LDK), ka prezantuar përvojat parlamentare të Kosovës për këto instrumente të demokracisë parlamentare. Temë e Panelit të dytë ka qenë: **“Mbikëqyrja e buxhetit” - përmirësimi i kontrollit nga e kaluara në të tashmen**, për të cilin kanë folur David Geerts, (Dhoma e përfaqësuesve Belg) dhe Joze Koncan (Drzavni Sbor, Slloveni), ndërsa ka raportuar deputetja Safete Hadërgjonaj, (PDK).

Në temën **“Mbikëqyrja përmes komisioneve funksionale dhe ato hetuese”** (Paneli e tretë) kanë folur Andrea Kerstges, (Bundestagu Gjerman), Alberik Goris, (Dhoma e përfaqësuesve Belg), për përvojat kosovare në këtë rrafsh ka raportuar

deputeti Mazllum Kumnova, (AAK), kurse debatit i ka kontribuar edhe kryetari i Komisionit Hetimor për të gjeturat faktike nga Zyra e Auditorit Gjeneral në Kuvendin e Kosovës, deputeti Ferid Agani (GP për Integrim). Ndërkaq, në Panelin e katërt në temën **“Mbikëqyrja e miratimit të ligjeve”** kanë shpjeguar Frank Baron, (Asambleja Franceze), Samo Kutosh, (Drzavni Sbor Slloveni), kurse ka raportuar deputetja Fatmire Mulhaxha-Kollçaku, (ORA).

Në orët e pasdites, seminari është përqendruar në **Mbështetjen Administrative për Kuvendin, e dhënë nga stafi i Kuvendit për seancën plenare dhe punën e komisioneve.**

Paneli i kanë drejtuar: Virtyt Ibrahimaga e Alfonz Lentze, (Projekti: Mbështetje e mëtejme për Kuvendin e Kosovës), Franklin De Vrieze dhe Michael Schuetz (OSBE), si dhe Edmond Efendia, (NDI).

Seminari ka sjellë përvoja interesante të jetës dinamike parlamentare në katër parlamentet evropiane, të cilat e mbështesin Kuvendin e Kosovës, sidomos sa i përket larmisë pyetjeve të deputetëve, përgjigjeve të rregullta të qeveritarëve në këto pyetje, të cilat bëhen në ditë të caktuara dhe transmetohen drejtpërdrejt në televizion. Për shkak të rrethanave të reja në Kuvendin e Kosovës, ka pasur ndërkaq interesim sidomos për procedurat e komisioneve hetimore.

Parlamentarët e Kosovës, në raport me katër parlamentet evropiane kanë mundur të lavdërohen vetëm për punën më të hapur të komisioneve parlamentare, megjithëse janë ankuar se salla e mbledhjeve të tyre janë tepër të ngushta për të pranuar edhe qytetarë që dëshirojnë të asistojnë në mbledhjet e komisioneve.

Seminari, i cili është organizuar nga Projekti për mbështetjen e Kuvendit të Kosovës dhe është përkrahur nga OSBE-ja dhe NDI-a vazhdon punën nesër (të mërkurën) në temën Mbështetje Administrative për punën rreth seancës plenare dhe punës së komisioneve në dritën e instrumenteve të përshkruara për mbikëqyrjen

parlamentare.

Në ditën e fundit të seminarit për mbikëqyrjen parlamentare të Qeverisë, organizuar Projekti për mbështetjen e Kuvendit të Kosovës dhe përkrahur nga OSBE-ja dhe NDI-a, punonjësit e stafit civilë të Kuvendit, janë njoftuar me praktikën e katër parlamenteve që e ndihmojnë legjislativin e Kosovës për mbështetjen administrative të seancës plenare dhe të komisioneve, me theks të veçantë evidencimit të dokumentacionit në Zyrën për parashtresa dhe komunikimin me mekanizma të Kuvendit dhe të Qeverisë.

Përfaqësues me përvojë nga Asambleja Nacionale Franceze, Bundestagu Gjerman, Dhoma e Përfaqësuesve Belg dhe Asambleja Nacionale e Sllovenisë, kanë shpjeguar përvojat e vendeve të tyre për evidentimin e rregullt të dokumenteve në Zyrën e Parashtresave dhe komunikimin e mekanizmave të Parlamentit, brendapërbrenda legjislativit dhe me Qeverinë.

Punonjës të sektorëve të ndryshëm të stafit civil të Kuvendit kanë shtruar shumë pyetje për sa i përket sajimit të agjendës për mbledhje të ndryshme në Kuvend, mbështetjes procedurale, organizimit të dëgjimeve publike, hartimit të rekomandimeve dhe raporteve të komisionit, shpërndarjes së ma materialeve etj.

Nga debati i djeshëm dhe i sotëm rezultoi se me një organizim më të mirë, sipas përvojave të vendeve me demokraci parlamentare të dëshmuar, mund të arrihen rezultate më të mira pune në Kuvendin e Kosovës dhe dinamikë më atraktive e punës parlamentare.

Në përmbyllje të këtij seminari udhëheqësi i ri i Projektit: Mbështetje e mëtejme për Kuvendin e Kosovës, Hugues de Courtivron, ka premtuar se në vazhdim të aftësimit të stafit civil do të organizohen disa vizita pune nëpër parlamentet që e mbështesin Kuvendin, kurse sekretari i Kuvendit, Ismet Krasniqi, duke i falënderuar organizatorët e takimit dhe ligjëruesit, ka shprehur gatishmërinë e përhershme të administratës së Kuvendit për bashkëpunim dhe ngritje profesionale të stafit.

U miratua raporti dhe rekomandimet për përmirësimin e gjendjes



Seanca plenare e Kuvendit të Kosovës, e drejtuar nga Kolë Berisha, kryetar i Kuvendit, ka shqyrtuar sot raportin e Komisionit për Shëndetësi lidhur me monitorimin e zbatimit të Ligjit për shëndetësinë.

Deputetët kanë bërë kritika të shumta për sa i përket funksionimit të sistemit shëndetësor në Kosovë, sidomos në planin e zbatimit të legjislacionit të miratuar për këtë lëmë të rëndësishëm të jetës.

Me këtë rast para deputetëve ka folur edhe Ministri i Shëndetësisë, Sadik Idriz, i cili ka theksuar kushtet e vështira teknike dhe financiare të institucioneve shëndetësore dhe të punonjësve në to, duke kërkuar një mbështetje më të madhe institucionale dhe shoqërore për shëndetësinë.

Në fund deputetët e kanë miratuar Raportin e Komisionit për Shëndetësi, bashkë me rekomandimet për përmirësimin e gjendjes.

Deputetët, ndërkaq, e kanë shtyrë për në një seancë tjetër shqyrtimin e propozimvendimit për lejimin e udhëtimeve zyrtare jashtë vendit, në mënyrë që në

ndërkohë të marrin informacion shtesë për praktikatat parlamentare të vendeve të tjera për këtë çështje.

Përfundimet e Komisionit bashkë me rekomandimet

Në bazë të fakteve relevante të cilat kanë rrjedhur nga puna e Komisionit gjatë vizitave në institucionet publike shëndetësore, dëgjimeve publike me Ministrin e Shëndetësisë dhe bashkëpunëtorët e tij, personat përgjegjës të institucioneve të cilat komisioni nuk ka arritur t'i vizitojë drejtpërsëdrejti, pas diskutimeve të shumta në komision dhe pas shqyrtimit të dokumentacionit relevant, komisioni ka arritur te këto përfundime: Me gjithë rezultatet e shënuara në disa fusha të sektorit, është e evidente se Ministria e Shëndetësisë, e preokupuar me probleme menaxheriale dhe vështirësi të natyrës tjetër, nuk ka arritur që të përmbushë në mënyrën e duhur funksionin e saj në përpilimin e politikave zhvillimore, si dhe hartimin, aprovimin dhe zbatimin e infrastrukturës përkatëse ligjore në përputhje me Ligjin për Shëndetësi. Ministria nuk ka plan kohor të zhvillimit të

legjislacionit të nevojshëm, si dhe të prioriteteve brenda tij. Kjo ka shkaktuar mungesën e aktivitetit të planifikuar në zbatimin e Ligjit.

Mosrespektimi i afateve të përcaktuara kohore për fillimin e punës të disa organeve dhe institucioneve të përcaktuara me Ligj është brengosës dhe ka pasur pasoja të konsiderueshme në sektorin e shëndetësisë. Kjo vlen veçanërisht për fillimin e funksionimit të Fondit për Sigurime Shëndetësore, si dhe Këshillit të Përgjithshëm Profesional, por edhe për riorganizimin e QKUK, si dhe koordinimin e punëve me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë sa i përket zhvillimit të aktiviteteve mësimore dhe shkencore në institucionet shëndetësore të nivelit tretësor.

Prandaj, me qëllim të tejkalimit të situatës së tanishme të pavolitshme, Komisioni konsideron se është i domosdoshëm zbatimi i rekomandimeve të bëra në këtë Raport.

PËRMBLEDHJA E REKOMANDIMEVE

Rekomandimi 1: Ministria e Shëndetësisë të caktojë prioritetet dhe afatet kohore për përpilimin dhe zbatimin e akteve nënligjore të përcaktuara me Ligj.

Rekomandimi 2. Ministria e Shëndetësisë, të procedojë me procedurë urgjente: Planin Strategjik për Zhvillimin e Sistemit të Kujdesit Shëndetësor dhe Planin Afatmesëm të Zhvillimit në të gjitha nivelet e kujdesit shëndetësor, për miratim në Qeveri dhe në Kuvendin e Kosovës; si dhe Planin Operativ të Zhvillimit të Kujdesit Parësor shëndetësor për miratim në Kuvendet Komunale.

Rekomandimi 3. Ministria e Shëndetësisë, të angazhohet për njoftimin e duhur të punëtorëve shëndetësorë dhe aktorëve të tjerë relevant me legjislacionin në fuqi.

Rekomandimi 4. Me qëllim të realizimit të këtyre detyrave dhe që Zyra Ligjore e Ministrisë të disponojë me numër të mjaftueshëm ekspertësh ligjor të domosdoshëm për përpilim të projekt-ligjeve, të akteve nënligjore, të raportit vjetor dhe të dokumentacionit tjetër të nevojshëm, Ministria e Shëndetësisë të marr në konsideratë ristrukturimin e personelit ekzistues.

Rekomandimi 5. Në pajtim me Rregullën 53 të Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, Ministria të raportojë me shkrim dhe me gojë një herë në vit në mbledhjet plenare të Kuvendit.

Rekomandimi 6. Ministria e Shëndetësisë të zgjidhë sa më parë çështjet e diskutueshme me Ministrinë për Ekonomi dhe Financa dhe Komisionin për Buxhet dhe Financa, në mënyrë që të hapet rruga për miratimin sa më të shpejtë të Ligjit për Sigurime Shëndetësore si ligj qenësor për shëndetësinë kosovare. Në këtë drejtim Qeveria e Kosovës duhet që me procedurë urgjente të amandamentojë Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.

Rekomandimi 7. Ministria e Shëndetësisë, të punojë

më shumë në përmirësimin e praktikës menaxhuese në institucionet shëndetësore dhe sidomos në përmirësimin e menaxhimit të financave dhe prokurimit.

Rekomandimi 8. Komisioni sugjeron Zyrën e Auditorit të Përgjithshëm që t'i jep prioritet auditimit të Ministrisë së Shëndetësisë.

Rekomandimi 9. Ministria e Shëndetësisë të ndërmarrë masa për të siguruar kontroll të brendshëm që do të parandalojë dhe eliminojë praktikën jo etike të punës në sektorin farmaceutik.

Rekomandimi 10. Ministria e Shëndetësisë, të zbatojë në mënyrë strikte Ligjin dhe të gjejë mënyrë efektive për të ndërprerë praktikën e dhënies së barnave nga persona që nuk janë farmacistë të licencuar.

Rekomandimi 11. Ministria e Shëndetësisë, të nxjerrë me procedurë urgjente aktin nënligjor me të cilin rregullohet furnizimi, depoimi, shpërndarja dhe disperzimi i barnave nga lista esenciale dhe mjeteve të tjera ndihmëse mjekësore, të evidentuara në regjistrin zyrtar.

Rekomandimi 12. Ministria e Shëndetësisë, të revidojë listën esenciale të barnave dhe materialit harxhues nga regjistri zyrtar, në pajtim me njohuritë bashkëkohore shkencore dhe profesionale, si dhe mundësitë reale të buxhetit të Ministrisë së Shëndetësisë.

Rekomandimi 13. Qeveria të rrisë buxhetin e Programit Farmaceutik, me qëllim të plotësimit sa më të mirë të furnizimit me artikuj nga Lista esenciale e barnave dhe materialin harxhues nga regjistri zyrtar.

Rekomandimi 14. Ministria të përgatisë një analizë kosto-përfitimi në lidhje me decentralizimin e prokurimit të artikujve nga Lista esenciale e barnave.

Rekomandimi 15. Ministria të marr masa kundër tendencës monopol dhe kualifikimit të interesave në tregun farmaceutik. Të forcohet kontrolli dhe garantimi i cilësisë së barnave që tregu të furnizohet me barna të standardeve Evropiane.

Rekomandimi 16. Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, me procedurë urgjente, të nxjerrin aktin nënligjor të përcaktuar me nenin 31.1 të Ligjit për Shëndetësi.

Rekomandimi 17. Qeveria (Ministria e Shëndetësisë) duhet të hartojë strategjinë efektive për zhvillimin e resurseve njerëzore në sektorin e shëndetësisë dhe t'ia paraqesë Kuvendit për miratim.

Rekomandimi 18. Ministria e Shëndetësisë të sigurojë zbatimin e aktit nënligjor, që rregullon edukimin themelor profesional të punëtorëve shëndetësorë pas përfundimit të fakultetit përkatës.

Rekomandimi 19. Ministria e Shëndetësisë, të sigurojë autonominë e plotë të Komiteteve specialistike sipas UA 17/2003 dhe të sigurojë ndalimin e çfarëdo lloji ndërhyrjeje dhe ndikimi në Bordin Qendror për Specializime me rastin e ndarjes së specializimeve, që është vërejtur në periudhën e deritanishme.

Rekomandimi 20. Ministria e Shëndetësisë, të këshillohet me institucionet shëndetësore lokale duke pasur

parasysh planet e tyre me rastin e shpërndarjes së specializimeve.

Rekomandimi 21. Ministria e Ekonomisë dhe Financave dhe Ministria e Shëndetësisë të sigurojnë mjete financiare për punësimin e punëtorëve shëndetësorë të cilët e kanë përfunduar me sukses edukimin e tyre specialistik, në bazë të planifikimit paraprak.

Rekomandimi 22. Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria për Ekonomi dhe Financa, të sigurojnë mjetet financiare për zhvillimin e vazhdueshëm profesional të punëtorëve shëndetësorë në bazë të Ligjit .

Rekomandimi 23. Ministria e Ekonomisë dhe Financave dhe Ministria e Shëndetësisë të sigurojnë, që të gjitha të hyrat vetanake të Ministrisë së Shëndetësisë, që krijohen në procesin e edukimit themelor profesional, të regjistrimit dhe të licencimit, si dhe të edukimit specialistik të punëtorëve shëndetësorë, të mund të shfrytëzohen në tërësi nga Ministria e Shëndetësisë në funksion të mundësit të zhvillimit profesional të punëtorëve shëndetësorë.

Rekomandimi 24. Ministria e Ekonomisë dhe Financave dhe Ministria e Shëndetësisë të sigurojnë, që pagesa e kujdestarive dhe punës në ndërrime, si punë e obliguar me Ligj, të bëhet nga burime të qëndrueshme buxhetore dhe jo nga mjetet financiare të grumbulluara nga bashkëpagesat e shfrytëzuesve të shërbimeve shëndetësore.

Rekomandimi 25. Ministria e Shëndetësisë të marrë masat e nevojshme për funksionalizimin urgjent të Sistemit Informativ Shëndetësor.

Rekomandimi 26. Ministria e Shëndetësisë, me procedurë urgjente, të nxjerrë aktin nënligjor për sistemin informativ në shëndetësi, që do të sigurojë krijimin dhe zhvillimin e qëndrueshëm të strukturës organizative dhe profesionale dhe krijimin dhe zhvillimin e dokumentacionit dhe raportimit të qëndrueshëm brenda SISH.

Rekomandimi 27. Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, me procedurë urgjente, të nxjerrin aktin nënligjor të përcaktuar me nenin 81, të Ligjit për Shëndetësi.

Rekomandimi 28. Ministria e Shëndetësisë me procedurë urgjente, të nxjerr aktin nënligjor të përcaktuar me nenin 82.1, të Ligjit.

Rekomandimi 29. Ministria e Shëndetësisë me procedurë urgjente, të nxjerr aktin nënligjor të përcaktuar me nenin 84.4, të Ligjit.

Rekomandimi 30. Ministria e Shëndetësisë me procedurë urgjente, të nxjerr aktin nënligjor të përcaktuar me nenin 85, të Ligjit.

Rekomandimi 31. Ministria e Shëndetësisë me procedurë urgjente, të nxjerr aktin nënligjor të përcaktuar me nenin 98.3, të Ligjit.

Rekomandimi 32. Ministria e Shëndetësisë, me procedurë urgjente të themelojë Grupin e punës për themelimin e Këshillit të Përgjithshëm Profesional në bazë të nenit 125 të, Ligjit.

Rekomandimi 33. Ministria e Shëndetësisë me proce-

durë urgjente, të përgatitë projektligjin e përcaktuar me nenin 109.2, të Ligjit.

Rekomandimi 34. Ministria e Shëndetësisë, të nxjerr aktin nënligjor të përcaktuar me nenin 113.1, të Ligjit.

Rekomandimi 35. Ministria e Shëndetësisë të përgatitë aktin nënligjor të përcaktuar me nenin 114.1, të Ligjit, që rregullon kujdesin shëndetësor në rrethana të gjendjes së jashtëzakonshme.

Rekomandimi 36. Ministria e Shëndetësisë të adresojë mungesën e resurseve humane, të infrastrukturës si dhe të mjeteve buxhetore që janë të nevojshme për funksionimin e kujdesit parësor.

Rekomandimi 37. Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Ekonomisë dhe Financave dhe Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në procedurë urgjente të nxjerrin aktin përkatës nënligjor, që do të rregullojë kompetencat e ndërsjella në nivelin e kujdesit parësor shëndetësor.

Rekomandimi 38. Ministria e Shëndetësisë të përshpejtojë realizimin e strategjisë me qëllim të realizimit të konceptit të mjekësisë familjare të përcaktuar me Ligj.

Rekomandimi 39. Ministria e Shëndetësisë, të ndërmarr masat për rishqyrtim të funksionimit të Zyrave të Autoritetit Shëndetësor në funksion të zvogëlimit të aparatit të panevojshëm administrativ.

Rekomandimi 40. Ministria e Shëndetësisë, të nxjerr aktin nënligjor të përcaktuar me nenin 29.3, të Ligjit.

Rekomandimi 41. Ministria e Shëndetësisë të nxjerrë aktin nënligjor të përcaktuar me nenin 78.2, të Ligjit.

Rekomandimi 42. Komisioni rekomandon zhvillimin e politikës regjionale të sistemit të referimit jashtë vendit.

Rekomandimi 43. Komisioni rekomandon Ministrinë e Shëndetësisë që sa më parë të përpilojë listën e shërbimeve shëndetësore të cilat mund të ofrohen në Kosovë, me qëllim të parandalimit të referimit të panevojshëm jashtë vendit.

Rekomandimi 44. Ministria e Shëndetësisë, të shtojë angazhimin për të siguruar qasje të barabartë dhe të papenguar të të gjitha komuniteteve në institucionet shëndetësore në Kosovë.

Rekomandimi 45. Ministria e Shëndetësisë, të nxjerr aktin nënligjor të përcaktuar me nenin 22.2 (c) të Ligjit.

Rekomandimi 46. Ministria e Shëndetësisë, të nxjerr aktin nënligjor të përcaktuar me nenin 22.2 (d), të Ligjit.

Rekomandimi 47. Ministria e Shëndetësisë, me procedurë urgjente, të përgatitë projektin e aktit ligjor të përcaktuar me nenin 24.6, të Ligjit.

Rekomandimi 48. Ministria e Shëndetësisë, të nxjerr aktet nënligjore të përcaktuara me nenet 37.2 dhe 38.3 të Ligjit.

Rekomandimi 49. Ministria e Shëndetësisë, të nxjerr aktin nënligjor të përcaktuar me nenin 39.2 të Ligjit.

Rekomandimi 50. Ministria e Shëndetësisë, me procedurë urgjente, të përgatitë projektin e aktit ligjor të përcaktuar me nenin 40.2, nenin 41, nenin 42 dhe nenin 43 të Ligjit.

Evidenca e Ligjeve

Legjislatura I (2001-2004) - Evidenca e Ligjeve të proceduara dhe të miratuara në Kuvendin e Kosovës

Nr	Emërtimi i Ligjit	Propozuesi	Nr. i Ligjit	Dt. e Miratimit	Rreg.Nr. dhe data e shpalljes nga PSSP
1.	Ligji themelor i pensioneve	Qeveria e Kosovës	2002/1	04.07.2002	2002/15 26.07.2002
2.	Ligji për arsimin Fillor dhe të Mesëm	-/-	2002/2	25.07.2002	2002/19 31.10.2002
3.	Ligji për arsimin e Lartë	-/-	2002/3	25.07.2002	2003/14 12.05.2003
4.	Ligji për Hipotekat	-/-	2002/4	17.10.2002	2002/21 20.12.2002
5.	Ligji për Krijimin e Regjistrave për drejtën Pronës	-/-	2002/5	17.10.2002	2002/22 20.12.2002
6.	Ligji mbi Aktivitetet e Tregtisë me jashtë	-/-	2002/6	08.05.2003	2003/15 12.05.2003
7.	Ligji për Telekomunikacionin	-/-	2002/7	08.05.2003	2003/16 12.05.2003
8.	Ligji për Mbrojtjen e Ambientit	-/-	2002/8	16.01.2003	2003/9 15.04.2003
9.	Ligji për Inspektoratin e Punës	-/-	2002/9	19.12.2002	2003/4 21.02.2003
10	Ligji për Menaxhimin e Financave Publike	-/-	2003/2	08.05.2003	2003/17 12.05.2003
11	Ligji për Pyjet e Kosovës	-/-	2003/3	13.02.2003	2003/6 20.03.2003
12	Ligji për Likuidimin dhe Riorganizimin e Pers. Jur	-/-	2003/4	13.03.2003	2003/7 14.04.2003
13	Ligji për Farërat	-/-	2003/5	20.03.2003	2003/10 15.04.2003
14	Ligji për Bibliotekat	-/-	2003/6	04.04.2003	2003/19 23.06.2003
15	Ligji për Lëndën Arkivore dhe Arkivat	-/-	2003/7	17.04.2003	2003/20 23.06.2003
16	Ligji për vendosjen e Tatimit në pronën e paluajt.	-/-	2003/8	17.04.2003	Si Rregullore e UNMIK-ut 2003/29 05.09.2003
17	Ligji për Kooperativat Bujqësore	-/-	2003/9	15.05.2003	2003/21 23.06.2003
18	Ligji për Plehtrat artificiale	-/-	2003/10	22.05.2003	2003/22 23.06.2003
19	Ligji për Rugët	-/-	2003/11	29.05.2003	2003/24 27.06.2003
20	Ligji për Qasjen në Dokumentet Zyrtare	-/-	2003/12	26.06.2003	2003/32 06.11.2003
21	Ligji për ndrysh. e plotës. të Ligjit 2002/5 Regjist. të pronës	-/-	2003/13	26.06.2003	2003/27 18.08.2003
22	Ligji për Planifikimin Hapësinor	-/-	2003/14	03.07.2003	2003/30 10.09.2003
23	Ligji për Skemën e Ndihmës Sociale	-/-	2003/15	11.07.2003	2003/28 18.08.2003
24	Ligji për regjistrimin e popullsisë,ekonom familjare	-/-	2003/16	11.07.2003	2004/53 13.12.2004
25	Ligji për Prokurimin Publik në Kosovë	-/-	2003/17	15.01.2004	2004/3 09.02.2004
26	Ligji për Shërbime Postare	-/-	2003/18	09.10.2003	2003/37 17.12.2003

Nr	Emërtimi i Ligjit	Propozuesi	Nr. i Ligjit	Data e Miratimit	Rreg.Nr. dhe data e shpalljes nga PSSP
27	Ligji për Siguri në punë, mbrojtje të shëndetit e amb.pu	Qeveria e Kosovës	2003/19	09.10.2003	2003/33 06.11.2003
28	Ligji për Pesticidet	-/-	2003/20	16.10.2003	2003/35 08.12.2003
29	Ligji për ndrysh.e plotësim. të Ligjit 2003/2 Menaxh.F.	-/-	2003/21	23.10.2003	2003/38 17.12.2003
30	Ligji për Inspektoratin Sanitar	-/-	2003/22	06.11.2003	2003/39 17.12.2003

31	Ligji për Pensionet e Aftësisë së Kufizuar	-/-	2003/23	06.11.2003	2003/40	17.12.2003
32	Ligji për Sportin	-/-	2003/24	20.11.2003	2004/26	28.07.2004
33	Ligji për Kadastër	-/-	2003/25	04.12.2003	2004/4	18.02.2004
34	Ligji për produktet dhe pajisjet medicinale	-/-	2003/26	04.12.2003	2004/23	07.07.2004
35	Ligji për Buxhetin e Kosovës për vitin 2004	-/-	2003/27	22.12.2003	Si Rregullorë e UNMIK-ut 2003/41 31.12.2003	
36	Ligji për Transport Rrugor	-/-	2004/1	24.03.2005	2005/23	09.05.2005
37	Ligji për barazi gjinore	Kuvendi i Kosovës	2004/2	19.02.2004	2004/18	07.06.2004
38	Ligji kundër Diskriminimit	Qeveria e Kosovës	2004/3	19.02.2004	2004/32	20.08.2004
39	Ligji për Shëndetësi	-/-	2004/4	19.02.2004	2004/31	20.08.2004
40	Ligji për bashkëpunim me Tribunalin e Hagës	-/-		19.02.2004	Vërejtje PSSP + Macion	
41	Ligji për Tregti me Naftë dhe Derivatet e saja	-/-	2004/5	22.04.2005	2005/22	07.05.2005
42	Ligji për Transportin e mallrave të rrezikshme	-/-	2004/6	01.04.2004	2004/17	05.06.2004
43	Ligji për Odën Ekonomike	-/-	2004/7	20.05.2005	2005/30	02.06.2005
44	Ligji për Energjinë	Kuvendi i Kosovës	2004/8	29.04.2004	2004/21	30.06.2004
45	Ligji për Rregullatorin e Energjisë	-/-	2004/9	29.04.2004	2004/20	30.06.2004
46	Ligji për Energjinë Elektrike	-/-	2004/10	29.04.2004	2004/22	30.06.2004
47	Ligji për Njësitë Matëse	Qeveria e Kosovës	2004/11	29.04.2004	2004/14	28.05.2004
48	Ligji për Standardizim	-/-	2004/12	29.04.2004	2004/15	28.05.2004
49	Ligji për Materialin Fidanor	-/-	2004/13	29.04.2004	2004/16	28.05.2004
50	Ligji për Marrëveshjet Ndërkombëtare Financiare	-/-	2004/14	06.05.2004	2004/30	09.08.2004
51	Ligji për Ndërtimin	-/-	2004/15	27.05.2004	2004/37	14.10.2004
52	Ligji për Veprimtaritë Hoteliere dhe Turistike	-/-	2004/16	27.05.2004	2005/6	03.02.2005
53	Ligji për Mbrojtjen e Konsumatorit	-/-	2004/17	16.06.2004	2004/42	19.10.2004
54	Ligji për Tregtinë e Brendshme	-/-	2004/18	16.06.2004	2004/43	20.10.2004
55	Ligji për Akademinë e Shkencave dhe të Arteve	Kuvendi i Kosovës	2004/19	16.06.2004	2004/25	28.07.2004
56	Ligji për Tatimin në të Ardhura Personale	Qeveria e Kosovës	2004/20	16.06.2004	Si Rregullorë e UNMIK-ut 2004/52 04.12.2004	
57	Ligji për Veterinarinë	-/-	2004/21	16.06.2004	2004/28	30.07.2004
58	Ligji për Kinematografinë e Kosovës	-/-	2004/22	08.07.2004	2004/38	14.10.2004
59	Ligji për Tatimin në Fitim	-/-	2004/23	08.07.2004	Si Rregullorë e UNMIK-ut 2004/51 04.12.2004	
60	Ligji për Ujërat	-/-	2004/24	08.07.2004	2004/41	14.10.2004
61	Ligji për detyrimet	-/-	2004/25	28.07.2004		

Nr	Emërtimi i Ligjit	Propozuesi	Nr. i Ligjit	Dt. e Miratimit	Rreg.Nr. dhe data e shpalljes nga PSSP
62	Ligji për trashëgiminë	Qeveria e Kosovës	2004/26	28.07.2004	2005/7 04.02.2005
63	Ligji për koncesionet	-/-	2004/27	28.07.2004	
64	Ligji për punimet nga metalet e çmuara	-/-	2004/28	28.07.2004	2004/33 24.08.2004

65	Ligji për plot. e ndryshim të Ligjit 2003/3 për pyje	Kuvendi i Kosovës	2004/29	28.07.2004	2004/40	14.10.2004
66	Ligji për mbrojtjen e ajrit nga ndotja	Qeveria e Kosovës	2004/30	28.07.2004	2004/48	25.11.2004
67	Ligji për të drejtat sendore	-/-	2004/31	08.09.2004		
68	Ligji për familjen	-/-	2004/32	20.01.2006	2006/7	16.02.2006
69	Ligji për blegtorinë e Kosovës	-/-	2004/33	08.09.2004	2004/39	14.10.2004
70	Ligji kundër korupcionit	-/-	2004/34	22.04.2005	2005/26	12.05.2005
71	Ligji për lojërat e fatit	-/-	2004/35	08.09.2004	2005/5	03.02.2005
72	Ligji për konkurrencën	-/-	2004/36	08.09.2004	2004/44	29.10.2004
73	Ligji për inspektionin e arsimit të Kosovës	-/-	2004/37	08.09.2004	2004/55	17.12.2004
74	Ligji për drejtat e përgj. e qytetarëve në kujdes shëndet	-/-	2004/38	08.09.2004	2004/47	19.11.2004
75	Ligji për shpalljen e kompleksit përkujtimor "Adem Jashari"	Kuvendi i Kosovës	2004/39	08.09.2004		
76	Ligji për avokatinë	-/-	2004/40	08.09.2004		
77	Ligji për financimin e partive politike në Kosovë	Qeveria e Kosovës	2004/41	27.09.2004		
78	Ligji për veprimtaritë kërkimore-shkencore	-/-	2004/42	27.09.2004	2005/8	23.02.2005
79	Ligji për tubimet publike	-/-	2004/43	27.09.2004		
80	Ligji për zejtari	-/-	2004/44	27.09.2004	2005/37	22.07.2005
81	Ligji për drejtën e autorit dhe të drejtat e afërta	-/-	2004/45	29.06.2006	2006/46	24.08.2006
82	Ligji për librin amzë	-/-	2004/46	27.09.2004	2005/21	07.05.2005
83	Ligji për gazetën zyrtare të Kosovës	-/-	2004/47	27.09.2004	2005/25	12.05.2005
84	Ligji për administratën tatimore dhe procedurat	-/-	2004/48	27.09.2004	2005/17	09.04.2005
85	Ligji për patentim	-/-	2004/49	27.09.2004	2004/56	21.12.2004
86	Ligji për shërbimin privat në shëndetësi	-/-	2004/50	27.09.2004	2005/1	13.01.2005

Kodet

Nr	Emërtimi i Kodit	Sponsorues	Rregullorja Nr. dhe data e shpalljes nga PSSP
1	Kodi Penal i Kosovës	UNMIK	2003/25 dt.06.07.2003 -ndryshimi 2004/19
2	Kodi i Procedurës Penale	-/-	2003/26 dt.06.07.2003
3	Kodi Doganor i Kosovës	-/-	2004/1 dt.30.01.2004
4	Ligji Penal për të Mitur	-/-	2004/8 dt.20.04.2004
5	Ligji për ekzekutimin e sanksioneve penale	-/-	2004/46 dt.19.11.2004



Deputetët e Kuvndit të Kosovës pajisen me laptop